



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT VENDIM

NR. _____ DATË _____
PËR

**MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE PËR BASHKINË
PËRMET PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 54, shkronja "f", të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Ligjit Nr. 9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, Ligjin 57/2020 "Për pyjet"; Ligjin Nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullësor", i ndryshuar, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, VKM nr.559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore, pyjore", i ndryshuar, Ligjin Nr.10 465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë"; Ligjin nr. 152/2015, datë 21.12.2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", VKM Nr.285 datë 27.06.2002 "Për tarifën e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin ndaj shtetasve dhe personave juridikë e fizikë, vendas e të huaj", VKM nr.784 datë 09.11.2016 "Për mënyrën dhe kriteret e llogaritjes së shpenzimeve të ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve në objektet e siguruar administrimin e përdorimit të të ardhurave, për llogari të shërbimit vendor të MZSH-së", VKM nr.467, dt.31.07.2025 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme", e pamë të arsyeshme që të kishte një ndryshim dhe në tarifën vendore që duhet të mbledhet nga njësitë administrative për taksën e kullotjes së bagëtitve", VKM nr.783 date 10.11.2011 "Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", VKM nr.132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

- I. Të miratojë nivelin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Përmet, sipas dokumentit bashkëngjitur.
- II. Të gjitha Vendimet e Këshillit Bashkiak që bien në kundërshtim me këtë akt, shfuqizohen.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit, si dhe të gjitha Drejtoritë e tjera pranë Bashkisë Përmet, Njësitë Administrative etj.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në 01.01.2026.

KRYETAR I BASHKISË
Alma Hoxha

Sheshi "Abdyl Frashëri", tel. +35581322254, e-mail: info@bashkipermet.gov.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

RELACION PËR PAKETËN FISKALE BASHKIA PËRMET 2026

“Qeveritë vendore luajnë një rol kritik në formësimin dhe zhvillimin e jetës shoqërore dhe ekonomike të territoreve të tyre, duke i sjellë komunitetet më pranë njëri-tjetrit dhe duke ofruar zgjidhje vendore për probleme vendore”

TAKSA DHE TARIFA 2026



Ky publikim mbështetet në kuadrin ligjor për vetëqeverisjen vendore, financat vendore, sistemin e taksave vendore, aktet nënligjore përkatëse dhe Vendimet e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Përmet.




**E nderuar Kryetare e Këshillit,
Të nderuar Këshilltarë,**

Ju paraqesim paketën fiskale me nivelet e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Përmet. Paketa fiskale është dokumenti bazë mbi të cilën mbështetet njësia vendore për të kryer aktivitetin e saj lidhur me njohjen dhe vjeljen e të ardhurave. Një paketë fiskale e qartë, e strukturuar siç duhet dhe reale është baza për të planifikuar një buxhet sa më të mirë.

A.1 Procesi i Hartimit të Paketës Fiskale

Për hartimin e paketës fiskale janë angazhuar drejtuesit dhe specialistët e te gjitha Drejtorive që funksionojnë në Bashkinë Përmet.





Dëgjesa Publike me qytetarë dhe grupe interesi

Hartimin e paketës fiskale të Bashkisë Përmet janë përfshirë përfaqësues të komunitetit të biznesit, banorë të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe këshilltarë. Gjatë muajit Shtator - Tetor, janë bërë dëgjesa publike për taksat dhe tarifatat vendore me përfaqësues të komuniteteve të Njësive Administrative Petran, Piskovë, Çarshovë dhe Frashër dhe grupe të interesit në NjA Përmet.

Dëgjesa u bënë dhe me Shoqërinë Civile, operatorët turistik, biznese të mëdhenjë e të vegjël që operojnë në qytet dhe Njësiti administrative.

Gjithashtu janë organizuar dëgjesa publike me përfaqësues të komunitetit të qytetit.

Gjatë këtyre takimeve ka patur pyetje, diskutime dhe propozime për përmirësimin e Draftit të Paketës Fiskale, të cilat u morrën parasysh nga ana jonë.

A.2 Çfarë prezanton Paketa Fiskale

Paketa fiskale e vitit 2026 është një rishikim i paketës së vitit të kaluar, tërësia e të cilës nuk është cënuar. Këto rishikime në paketë janë bërë pas takimeve me grupet e interesit dhe bazuar në amendimet ligjore.

Në mënyrë të përmbledhur kjo paketë fiskale synon:

- a) Hartimin e një pakete fiskale të integruar;
- b) Rishikimin e kornizës ligjore me qëllim përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe çdo pagese tjetër që ndikon në buxhetin vendor dhe për të cilat njësia vendore duhet të arkëtojë të ardhura;
- c) Saktësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësi për çdo taksë dhe tarifë pjesë e kësaj pakete fiskale.
- d) Përcaktimi i saktë i të gjithë elementëve të lidhur me menaxhimin do të pasurojë akoma më tej dhe do të vendosë një bazë të fortë për ndërtimin e një sistemi fiskal eficient dhe transparent.
- e) Përcaktimin e qartë dhe ndarjen në seksione e taksave nga tarifat. Çdo taksë dhe tarifë do të detajohet duke patur në konsideratë elementë:
 - ✓ Taksim i drejtë;
 - ✓ Tarifim mbështetur në kosto;
 - ✓ Klasifikimi i biznesit, qarkullim vjetor, lloji i aktivitetit;
 - ✓ Qartësimi dhe përcaktimi i taksave apo tarifave që aplikohen për kategorinë e familjeve nisur nga lloji, vendndodhja etj;
- h) Analiza e taksave që aplikohen për territorin që mbulon njësia (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha taksat, përcaktimi i bazës së taksueshme dhe aplikimi i kufijve që përcakton ligji;
- i) Rikategorizimi dhe detajimi i taksave;
- j) Analiza e tarifave që aplikohen për territorin që mbulon njësia (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha tarifat, përcaktimi i nivelit të tarifave mbështetur në koston e shërbimit për të cilin vendosen;



Applikimi i nxitjeve apo lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë, parashikon ligji.

Vizioni ynë, për një territor bashkiak të integruar, parashikon planifikim dhe investime që krijojnë mundësi për një zhvillim të qëndrueshëm të balancuar për të gjithë territorin, duke mbrojtur burimet natyrore.

Kjo qasje bazohet në përforcimin e identitetit të secilës zonë të Bashkisë, duke patur parasysh burimet natyrore, profilin ekonomik dhe produktet, shtrirjen e shërbimeve dhe traditën, me synimin e përhershëm të rritjes së nivelit të jetesës. Mirëadministrimi i burimeve financiare nëpërmjet planifikimit sa më real të paketës fiskale si dhe zbatimi me rigorozitet i rregulloreve dhe urdhëresave përbën moton e punës tonë. Planifikimin e kemi mbështetur në shpërndarjen sa më të drejtë të ngarkesës tatimore duke bërë përcaktimin e nivelit të tarifës sipas llojit të aktivitetit, sipas vendodhjes gjeografike, duke lehtësuar bizneset në zonat më pak të zhvilluara. Ne synojmë që të kemi në dorë një mekanizëm i cili na ndihmon për të arritur objektivat në realizimin e prioriteteve të identifikuara në planet tona strategjike më afatgjata. Propozimet janë në përputhje edhe me ndryshimet ligjore të ndodhura.

Në Paketën Fiskale të vitit 2026 janë bërë këto ndryshime :

Paketa fiskale është rishikuar me kujdes për të reflektuar një balancë mes nevojave të komunitetit dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Ndryshimet janë realizuar pas një procesi gjithëpërfshirës konsultimi me grupet e interesit, duke përfshirë qytetarët, bizneset dhe ekspertët e fushës. Këto përmirësime synojnë të lehtësojnë barrën fiskale për individët dhe bizneset, ndërsa forcojnë bazën financiare për ofrimin e shërbimeve publike cilësore. Ne materialin që ju kemi paraqitur kemi kryer keto rishikime:

1.1.b. Taksa mbi tokën bujqësore.

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

Ishte 1 000 lekë/ha, bëhet përsëri 1 000 lekë/ha në NjA Frashër dhe zonat e tjera malore të të gjitha Njësi Administrative dhe 1 200 lekë/ha në Zonat fushore ose zonat e luginës.

Edhe pse fshatrat e njësi Administrative e kanë shtrirjen gjeografike në terren malor nëse posedojnë tokën bujqësore në zonat fushore taksa e tokës është 1 200 lekë/ha.

1. Në seksionin e Taksave kemi saktësuar piken 1.2, taksa e fjetjes në hotel, konkretisht:

Subjekti që derdh këtë taksë duhet të pajiset me regjistër deklarimi për fjetet në hotel, i cili duhet të jetë sekretuar me vulë të njomë nga Bashkia Përmet.

Ky regjistër do të jetë objekt i kontrollit brenda datës 15 të muajit pasardhës, nga punonjësit e Sektorit të Tatim Taksave, pranë Bashkisë Përmet, ose subjektit i lind e drejta ta paraqes vetë këtë regjistër pranë këtij Sektorin në datën e përcaktuar më sipër.

Taksimi i subjekteve akomoduese për taksën e fjetjes në hotel do të bëhet bazuar në Vendimin e KB nr.89, datë 22.10.2025.

Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, bëhet brenda datës 20 të muajit pasardhës.

Tatimpaguesi, i cili nuk paguan, brenda afatit të parashikuar, shumën e detyrimit tatimor, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer.

2.Në seksionin e tarifave vendore të Bashkisë Përmet janë prapozuar ndryshimet e mëposhtme:

J. Tarifa nga Urbanistika

1- Pika 4 b Tarifa për shërbim ishte :

b.Kryerje punimesh për të cilat nuk është e nevojshme pajisja me leje ndërtimi apo deklaratë paraprake për kryerje punimesh 2000 lekë bëhet:

b-Kryerje punimesh për të cilat nuk është e nevojshme pajisja me leje ndërtimi apo deklaratë paraprake për kryerje punimesh	Ishte 2000
- Punimet civile për rrjetet ose sistemet e komunikimeve elektronike/telekomunikacioni në rastet e mëposhtme	5 000 lekë
- Ndërtimi i çative të pashfrytëzueshme në zonat rurale	5 000 lekë
-	
- Vendorsja e pergolateve, në përputhje me ligjin që rregullon bashkëpronësinë në objektet e banimit;	5 000 lekë
- Mur mbajtës për tarracimet e tokave bujqësore në pronësi, si dhe/apo mur rrethues të tokës bujqësore dhe objekteve në zonat rurale në pronësi, pa shkaktuar dëmtim të infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit;	5 000 lekë
- Vendorsja e serrave të çmontueshme, pa themele të vazhduara, në shërbim të aktiviteteve bujqësore.	5 000 lekë
-	
- Struktura që instalohen për nevoja të çastit dhe/ose të përkohshme, pa themele, me materiale të çmontueshme, pa përdorur struktura beton-armeje, blloqe betoni, muratura e soleta dhe që hiqen në çdo	10 000 lekë



rast, brenda një afati kohor maksimal 12-mujor nga momenti i lëshimit	
Kategoritë e tjera te punimeve sipas Nenit 6 dhe 6/1 te VKM 408 dt.13.05.2015	2 000 lekë

2- Në pikën N) Tarifë për dhënie licence për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj është bërë shtesë shënimi:

Shënim: Në rast se subjekti që kërkon të pajiset me licencë, për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante, kërkon që për pamjaftueshmëri të likuiditetit të kryej pagesë me këste, edhe të drejtën për tu pajisur me licencë në kohëzgjatje e ka në bazë të kësteve që paguan.

3. Tarifa licencimi të transportit të udhëtarëve është bërë shtesë gjithë paragrafi, konformë VKB nr.56, datë 02.07.2025.

Nr	Tarifat e licensimit të transportit të udhëtarëve	Njësia	Tarifa
a	b	c	d
1	Licensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	lek/10-vjet/linjë	30,000
2	Certifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	lek/mjet/5-vjet	5,000
3	Licensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	lek/10-vjet/linjë	40,000
4	Certifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	lek/mjet/5-vjet	5,000
5	Licenca për shërbimet e rregullta të specializuara të transportit të udhëtarëve brenda vëndit	lek/5-vjet	20,000
6	Certifikatë për shërbimet e rregullta të specializuara të transportit të udhëtarëve brenda vëndit	lek/mjet/5-vjet	5,000
7	Licenca për kryerjen e shërbimeve vajtje-ardhje (lavjerës) të transportit të udhëtarëve brenda vëndit	lek/5-vjet	20,000
8	Certifikatë për kryerjen e shërbimeve vajtje-ardhje (lavjerës) të transportit të udhëtarëve brenda vëndit	lek/mjet/5-vjet	5,000
9	Certifikatë për kryerjen e shërbimeve të transportit të udhëtarëve për llogari të vet	lek/mjet/5-vjet	5,000
10	Licensë për agjensi transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vëndit	lek/5-vjet	15,000

11	Licensë për agjensi transporti ndërkombëtar udhëtarësh	lek/5-vjet	40,000
12	Licensë për transport udhëtarësh me taksi brënda vëndit	lek/5-vjet	20,000
13	Libri i udhëtimit për shërbime turistike/të rastit" brënda vëndit (nr i fletëve/nr i udhëtimeve 25)	lek/libër/pa afat	5,000

Vendosja e kësaj tarife është bërë konform gjithë bazës ligjore për transportin rrugor,të udhëtarëve.

4- Tarifa e pastrimit ishte 2,400 lekë për popullatën e të gjitha njësive administrative dhe qytetin, bëhet 3,000 lekë për popullatën në qytet.

Duke parë fluksin e lartë të heqjes së mbetjeve në qytet ,mbetje të ngurta,mbetje të gjelbërta dhe mbetjet e tjera të familjarëve,kosto e heqjes së tyre është më e lartë .

Me sygjerim të Sektorit të Mbetjeve ,e pamë të arsyeshme të bënim ndryshimin e tarifës së largimit të mbetjeve nga 2,400 lekë në qytet në 3,000 lekë.

5- Tarifa e ndricimit për të gjithë Guest Hauset dhe Apartamentet ishte 0 lekë bëhet 4 000 lekë.

6- Trifa e gjelbërimit për Guest Hauset ishte 0 lekë,bëhet 2 200 lekë.

Këto dy tarifa do të jenë njëloj si për qytetin dhe njësitë administrative qëndër Carcovë,Petran,Piskovë,dhe Frashër.

7-Tarifa pastrimit do të jetë 9 100 lekë si për Guest Hauset dhe Apartamentet,në qytet dhe njësitë administrative Carcovë,Petran,Piskovë,dhe Frashër.

8.Pika DH Tarifa për subjekte fitues në tendera me seli jashtë territorit të Bashkisë Përmet(tarifa për pastrim,gjelbërim,ndricim),behet:

- Me vlerë kontrate deri më 5 milion lekë 30,000 lekë /tender/vit,pastrim
20,000 lekë/tender/vit,ndricim
10,000 lekë/tender/vit,gjelbërim
- Me vlerë 5-10 milion 50,000 lekë /tender/vit,pastrim
30,000 lekë/tender/vit,ndricim
15,000 lekë/tender/vit,gjelbërim
- Me vlerë mbi 10 milion 70,000 lekë /tender/vit,pastrim
50,000 lekë/tender/vit,ndricim
30,000 lekë/tender/vit,gjelbërim

9. Në seksionin e taksave e tarifave vendore për njësitë Administrative

1. Pika 5) Tarifa për vaditje në njësitë administrative shtohet te pika 5.1 si më poshtë:

-Me pompë me korent dhe

- Pompë 50 l/sek 2 000 lekë/orë
- Pompë 40 l/sek 1 600 lekë/orë

10. Pika 8 Tarifa të kullotjes së bagëtive ishte :

8.	Tarifat e kullotës së bagëtive	
a	Per çdo krere dhen	
a.1	Per kullota dimerore	100 lekë/krerë
a.2	Per kullota verore	100 lekë/krerë
a.3	Ne pyje qe kulloten	50 lekë/krerë
b	Per çdo krere dhi	
b.1	Per kullota dimerore	100 lekë/krerë
b.2	Per kullota verore	80 lekë/krerë
b.3	Ne pyje qe kulloten	100 lekë/krerë
c	Per çdo krere te trasha(gjedhe)	
c.1	Per kullota dimerore	800 lekë/krerë
c.2	Per kullota verore	800 lekë/krerë
c.3	Ne pyje qe kulloten	60 lekë/krerë
d	Per çdo krere njethundrake	
d.1	Per kullota dimerore	800 lekë/krerë
d.2	Per kullota verore	800 lekë/krerë
d.3	Ne pyje qe kulloten	60 lekë/krerë

	Tarife vjetore per perdorim te siperfaqes se tokes per ndertime provizore ne fondin kullosor nga fermeret qe mbareshtrojne bageti	
a	Qender stani te rrethuar	
a.1	-Kullote dimerore/verore	50 lekë/m²/vit
a.2	- Pyje qe kulloten	50 lekë/m²/vit
b	Ngrehina per barinj	
b.1	- Kullote dimerore/verore	50 lekë/m²/vit
b.2	- Pyje qe kulloten	50 lekë/m²/vit
c	Mullinj magazina	
c.1	-Kullote dimerore / verore	100 lekë/m²/vit
c.2	-Pyje qe kulloten	100 lekë/m²/vit
d	Qender perpunim bulmeti	
d.1	- Kullote dimerore / verore	100 lekë/m²/vit
d.2	-Pyje qe kulloten	100 lekë/m²/vit
c	Për cdo koshere blete tarifa do të jetë	50 lekë/koshere/ vit

Me ndryshimin e bazës ligjore me VKM nr.467,dt.31.07.2025 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme", e pamë të arsyeshme që të kishte një ndryshim dhe në tarifën vendore që duhet të mblidhet nga njësitë administrative për taksën e kullotjes së bagëtive.

Deri më sot kjo taksë mblidhej nga Sektori i Pyjeve, vetëm për blektorët që lidhnin kontarta me Sektorin e Shërbimit Pyjor. Në vazhdimësi kjo tarifë do të mblidhet në këtë mënyrë :

- Për të gjithë blektorët që lidhin kontrata të rregullta me Sektorin e Shërbimit Pyjor, nuk do të paguhet tarifa vendore, për kullotje ,por do të mblidhet kjo tarifë konform VKM nr.467, datë 31.07.2025.

- Për blektorët që nuk kanë kontrata me këtë sektor do të paguhet tarifa e kullotjes së bagëtive në njësinë administrative ku bëjnë pjesë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
Vendosja e kësaj tarife bëhet nëpërmjet Agjentit Tatimor Sh.a Ujësllës për të gjithë blektorët që kanë kontrata uji me ujësllësin dhe nëpërmjet punonjësve të njësive administrative për ata blektor që nuk kanë kontrata uji me ujësllësin.

PËRJASHTIMET:

1. Ishte : Përfshihen nga tarifat vendore për popullatën invalidët, veteranët, të verbërit kur janë kryefamiljare dhe familje me ndihmë ekonomike, familje me fëmijë me aftësi ndryshe, familje me përbërje vetëm pensionistë me të ardhura mujore deri në 30.000 lekë/muaj.

Shtohet : Përfshihen nga tarifat vendore për popullatën dhe personat me aftësi ndryshe, kur janë kryefamiljare dhe familje që trajtohen me ndihmë sociale, ky përfshitim vlen dhe për kryefamiljarët në Nja në varësi të Bashkisë Përmet.

A.3 Baza ligjore

Në mbështetje të nenit 54, shkronja "P", të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Ligjit Nr. 9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, Ligjin. Nr. 57/2020 "Për pyjet", Ligjin Nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullësor", i ndryshuar, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, VKM nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore", i ndryshuar, Ligjin Nr.10 465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr. 152/2015, datë 21.12.2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", VKM Nr.285 datë 27.06.2002 "Për tarifat e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin ndaj shtetasve dhe personave juridikë e fizikë, vendas e të huaj", VKM nr.784 datë 09.11.2016 "Për mënyrën dhe kriteret e llogaritjes së shpenzimeve të ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve në objektet e siguruar administrimin e përdorimit të të ardhurave, për llogaritje shërbimit vendor të MZSH-së", VKM Nr.632, datë 11.6.2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve përkullotje dhe kositje", VKM nr.783 date 10.11.2011 "Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", VKM nr.132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

Me VKM nr.467, dt.31.07.2025 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e

energjisë së rinovueshme", e pamë të arsyeshme që të kishte një ndryshim dhe në tarifën vendore që duhet të mbliqet nga njësitë administrative për taksën e kullotjes së bagëtive".

Bazuar në të gjithë sa më sipër, ju paraqesim propozimet tona për sistemin e ri të taksave dhe tarifave që ne duam të zbatojmë për periudhën në vazhdim, duke qenë në linjë dhe në zbatim të prioritetëve të strategjisë së Bashkisë Përmet.

Ju faleminderit!

Kryetar i Bashkisë
Sekretar i Përgjithshëm
Nënkryetar
Nënkryetar
Drejtor i Buxhet- Financë , Burimeve Njerëzore dhe shërb. mbësh.
Drejtor i Zhvillimit Ekonomik
Përgjegjës i Tatim-Taksave, Aseteve dhe Liqencave
Drejtor i Planifikimit Urban dhe prokurimeve
Përgjegjës i Zyrës Juridike dhe Prokurimeve
Përgjegjës i Pastrim Gjellbërimit
Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes
Përgjegjës i MZSH
Drejtor i Shërbimeve Sociale, Arsimit, Kulturës , Sporteve
Përgjegjës e Qendrës për Fëmijët në Nevojë
Drejtor i Integritetit Europian , projekteve dhe Rinise
Përgjegjës Sektori i Pyjeve
Drejtor i Arsimit Parashkollor
Administrator i Njesisë Administrative Përmet
Administrator i Shërbimeve
Administrator i Njesisë Administrative Çarshovë
Administrator i Njesisë Administrative Petran
Administrator i Njesisë Administrative Piskovë
Administrator i Njesisë Administrative Frashër

Alma	HOXHA
Denisa	DURRO
Aulona	MESHINI
Florand	HASANI
Etleva	KRECI
Etleva	MYFTARI
Dorjan	METKO
Laert	BUSHI
Enea	KUSHE
Eftali	LAPAJ
Flavio	GUCI
Fredi	LIPE
Arjana	PAPAPANO
Suela	RIZAJ
Klaudja	CIKO
Bledar	TESHO
Manjola	MEHMETI
Kristjana	IBRAHIMI
Arjan	JAUPI
Ilia	JANI
Ylli	DERVISHI
Juxhin	PASHO
Maringlen	SPAHIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. ____ Date ____/____/____

PËR

**MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË ASTETEVE (MJET FADROMË TIP JCB DHE
KAMION TIP MAN) NË ADMINISTRIM TË SEKTORIT TË RRUGËVE RURALE PËR
NEVOJA TË BORDIT TË KULLIMIT NË BASHKINË PËRMET.**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 24/2017
“Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit” si dhe relacionin e paraqitur, me propozim të Kryetarit
të Bashkisë :

VENDOSI:

1. Të miratojë përdorimin e asteteve (mjet fadromë tip JCB dhe kamion tip MAN) në administrim të sektorit të rrugëve rurale për nevoja të bordit të kullimit në Bashki në Përmet.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori Rrugeve Rurale, Bordi i Kullimit dhe Drejtoria e Financë Buxheti/Burime Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË
ALMA HOXH





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
Sektori i Rrugëve Rurale dhe Bordit të Kullimit



RELACION

Për miratimin e përdorimit të aseteve (automjete) në administrim të sektorit të Rrugëve Rurale për nevoja të Bordit të Kullimit në bashkinë Përmet

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 27 “Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave”, pika 1 ku shprehet se bashkitë janë përgjegjëse për administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës ujitëse dhe kullimit, të transfetuara në pronësi të tyre, dhe sipas ligjin nr.24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”.

Përsa më sipër, ligji ngarkon me përgjegjësi bashkinë dhe kryetarin e saj, për ti ardhur në ndihmë komunitetit duke përdorur me efikasitet të lartë dhe ritur koficientin e përdorit dhe shfrytëzimin të të gjitha mjetet dhe burimet materiale që ka në dispozicion.

Në këtë kuadër, organizimi i bërë duke bashkuar në një njësi Bordin e Kullimit me Rrugët Rurale, ka patur për qëllim rritjen dhe maksimizimin e shfrytëzimit të mjeteve mekanike duke i grupuar në mënyrë që të bëhet e mundur mirëadministrimi i tyre si nga ana organizative ashtu dhe teknike.

Në inventarin e mjeteve mekanike rrugët rurale kanë dy mjete (eskavator JCB dhe kaminon MAN) ndërsa bordi i kullimit dhe ujitjes ka një mjet (eskavator me zinxhira VOLVO). Këto mjete duhet të punojnë të alternuar për të ritur eficienten dhe koeficientin e përdorimit.

Kjo do të kërkojë dhe përdorimin e fondeve për mirëmbajtjen e mjeteve apo shërbimeve të tjera në kuadër të njësisë si një e tërë.

Përsa më lartë kërkojmë miratimin nga ana juaj.

NËNKRYETAR I BASHKISË
Florand HASANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ dt _____ / _____ /2025.

PËR
MIRATIMIN E NORMATIVAVE TË HARXHIMIT TE DRUVE TË ZJARRIT PËR
SHKOLLAT -KOPËSHTET-ÇERDHET E BASHKISË PËRMET.

Këshilli Bashkiak Përmët i mbledhur më datën ____/____/2025 Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 dt 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 69/2012 Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, Ligjin nr 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin 68/2017 “Për Financat e vetëqeverisjes vendore” Urdherit të Kryetarit të Bashkisë nr. 502 datë: 20.11.2025 “Për ngritjen e Komisionit për përcaktimin e normativave të druve të zjarrit për ngroje në shkollat, kopështet dhe çerdhet e Bashkisë Përmët”, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Komisioni dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

VENDOSI:

- 1- Furnizimi me dru zjarri për shkollat-kopështet dhe çerdhet në varësi të Bashkisë Përmët të bëhet për periudhën: **01 Janar 2026 – 15 Mars 2026**, dhe periudhën: **15 Nëntor 2026 - 31 Dhjetor 2026**.
- 2- Normativat e harxhimit të druve të zjarrit për sobat e shkollave, kopështete në Nj.Ad në varësi të Bashkisë Përmët të jetë: **5 m/st dru për cdo sobë në sezon**.
- 3- Normativa e druve të zjarrit për kaldajat e shkollave të Qytetit Përmët të jetë: **0.7 m/st në ditë**.
- 4- Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë,dhe Turizmit Sektori Juridik/Burimet njerezore, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave, Drejtoria e Financë-Buxhetit-Taksa Tregje dhe Shërbimeve Publike në Nj.Administrative.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISË

Alma Hoxha





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOMISIONI PER NORMATIVAT E DRUVE TË ZJARRIT**

Permet me ____/____/2025.

RELACION

Për

Miratimin e normativave të harxhimit të druve të zjarrit për shkollat dhe kopeshtet e Bashkise Permet per sezonin e dimeror: 01 Janar 2026 – 15 mars 2026, dhe periudhën 15 Nëntor 2026 - 31 Dhjetor 2026.

Të nderuar!

Komisioni, Bazuar ne ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015” Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjin nr. 69/2012 Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, dhe detyrimin që Bashkia ka për furnizimin me ngrohje të institucioneve arsimore në territorin e Bashkise Permet, Urdhërit të Kryetarit të Bashkise nr nr 502 datë 20.11.2025 “Për ngritjen e Komisionit për përcaktimin e normativave të druve të zjarrit për ngroje në shkollat, kopështet dhe çerdhet e Bashkisë Përmet”, hartoi kete relacion si më poshte:

Të dhëna të përgjithëshme

Nisuar edhe nga eksperiencia e viteve të kaluara shpërndarja e sasive të nevojshme të druve të zjarrit e ndarë sipas institucioneve arsimore është si më poshtë:

A- Shkollat e qytetit.

- Gjimnazi “Sami Frashëri” kaldaje me lëndë djegëse “dru”. Normativa e harxhimit 0.7 m3/dite.
- Shkolla 9-vjeçare “Nonda Bulka” kaldaje me lëndë djegëse “dru”. Normativa e harxhimit 0.7 m3/dite.
- Për shkak të investimit në rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare “Meleq Gosnishti” kaldaja e kësaj shkolle do të jetë në funksion me lëndë djegëse “gaz”, (tabela nr 1)

B- Kopështet në qytetin e Përmetit. (tabela nr 2)

- Kopështi nr 1 “Agllahi Tako” janë 4 soba. Ngrohja me dru zjarri,
- Kopështi nr 2 “Ngjeli Gogo” ngrohja realizohet me kaldaje me naftë
- Kopësht-çerdhe “Mejden” 2 soba zjarri.

C- Persa i perket shkollave edhe kopeshteve në Njesitë Administrative Carshove, Petran, Piskove, ngrohja realizohet me soba me dru zjarri. (tabelat e meposhteme 3,4,5 bashkelidhur) Në Nj.Ad. Frashër nuk ka në funksion shkolla dhe kopështe, dhe rrjedhimisht nuk është e nevojshme furnizimi i me dru zjarri.

D- Nga verifikimet dhe testimet e kryera në kohe dhe periudha të ndryshme për konsumin e druve të zjarrit rezulton se:

- i. Konsumi i druve të zjarrit për sobat në klasat e shkollave e kopeshteve është 5 m3 për periudhën e vitit mësimor.
- ii. Konsumi i druve të zjarrit në kaldajat me dru në shkollën 9-vjeçare “Nonda Bulka” është 0.7 m3/dite, po kështu edhe kaldaja e gjimnazit “Sami Frasheri” konsumi ditor është 0.7 m3/dite.



- iii. Në raport me vitin e kaluar sasia e druve ishte parashikuar 377,5 m/st për vitin 2025, për vitin 2026 sasia e nevojeshme është 280 m/st për shkak të uljes së nr të klasave në shkollat e Nj.Ad si dhe kalidajës së shkollës "Meleq Gonishti: e cila do të funksionojë me lëndë djegëse "gaz"

Tabela nr 1

Shkolla+kopeshte Qyteti Permet

Nr	Shkollat qyteti Përmet	Nr i kalidajave	Norma per 1 dite m/st	Dite ngrohje	Sasia m/st
1	Gjimnazi "Sami Frasheri"	1	0.7	75	52.5
2	Shkolla 9-vjeçare "Nonda Bulka"	1	0.7	75	52.5
Totali vjetor		2			105

Tabela nr 2

Kopeshtet e Qytetit.

Nr	Kopeshtet qyteti Përmet	Nr i sobave	Norma vjetore m/st	Dite ngrohje	Sasia m/st
1	Kopështi nr -1	4	5	75	20
2	Kopështi nr 3 Mejden	2	5	75	10
Totali vjetor		6			30

E- Njësia Administrative Piskove.

Tabela nr3

Shkolla+kopështe Nj.Ad. Piskove

Nr	Shkolla/kopeshte	Nr i sobave ne shkolle	Nr i sobave ne kopesht	Nr gjithsej	Norma vjetore m/st	Sasia e harxhimit vit m/st
1	Shkolla Piskove +kopeshti 1 sobe	6	1	7	5	35
2	Shkolla Kosine +kopeshti 1 sobe	2	1	3	5	15
3	Shkola Kutal	1	0	1	5	5
4	Shkolla Rapcke	1	0	1	5	5
5	Shkolla Pacomit +kopeshti 1 sobe	1	1	2	5	10
8	Shkolla Buhal	1	0	1	5	5
Totali		12	3	15		75

F- Njësia Administrative Petran.

(tabela nr 4)

Shkolla+kopeshte, Nj.Ad.PETRAN

Nr	Shkolla/kopeshte	Nr i sobave ne shkolle	Nr i sobave ne kopesht	Nr gjithsej	Norma vjetore m/st	Sasia e harxhimit vit m/st
1	Shkolla Petran	2	1	3	5	15
2	Shkolla Kaluth	1	1	2	5	10
3	Shkolla Gjinkar	1	0	1	5	5
Totali vjetor		4	2	6		30

G- Njësia Administrative Çarçove.

(tabela nr 5)

Shkolla+kopeshte, Nj.Ad.CARSHOVE

Nr	Shkolla/kopeshte	Nr i sobave ne shkolle	Nr i sobave ne kopesht	Nr gjithsej	Norma vjetore m/st	Sasia e harxhimit vit m/st
1	Shkolla Iljare	6	0	6	5	30
2	Shkolla Çarçove	1	0	1	5	5

3.	Shkolla Dragove	1	0	1	5	5
	Totali vjetor	8	0	8		40



Totali i nevojeshëm për dru zjarri ne institucionet arsimore vitit 2026 në Bashkinë Përmet të jetë 280 m/st.

Sasia e nevojeshme per dru zjarri ne objektet arsimore viti mesimor 2026 (1 Janar-15 Mars & 15 Nëntor -31 Dhjetor 2026) BASHKIA PERMET

Nr	Shkolla/kopështe	Nr i kaldajave	Nr i sobave ne shkolle	Nr i sobave ne kopesht	Nr gjithsej	Norma vjetore m/st	Dite ngrohje	Sasia e harxhimit vit m/st
1	Shkollat e qytetit Permet (kaldaja me dru)	2	0		2	0.7	75	105
2	Kopeshtet qytet (soba)	0	0	6	6	5	-	30
3	Shkolla+kopeshte Nj.Ad. Piskove (soba)	0	12	3	15	5	-	75
4	Shkolla+kopeshte Nj.Ad. Petran (soba)	0	4	2	6	5	-	30
5	Shkolla+kopeshte Nj.Ad. Çarçove (soba)	0	8	0	8	5	-	40
	Totali vjetor	2	24	11	37	5		280

Sa më sipër Komisioni i Propozon Këshillit Bashkiak miratimin e normativave të harxhimit të druve te zjarrit për sobat e drurit, kaldajat me djegje me dru, për shkollat-kopeshtet-çerdhet e Bashkisë për periudhën: **1 Janar 2026 - 15 Mars 2026** dhe periudhën: **15 Nëntor 2026 -31 Dhjetor 2026.**

Hartuesit e këtij Relacioni

KOMISIONI

Administratori i Shërbimeve Publike
Arian JAUPI

Punonjesi i Shërbimeve në Nj.Ad.Petran
Spiro Cela

Punonjesi i Shërbimeve në Nj.Ad.Çarçovë
Janaq Kristo

Punonjësi i Shërbimeve në Nj.Ad.Piskovë
Muarrem Zeqillari

Punonjesi i Shërbimeve në Nj.Ad.Frashër
Arben Mustafaj



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET**

PROJEKT VENDIM

NR. _____ DATË _____

PËR

MIRATIMIN E SASISË SË KARBURANTIT TË AUTOMJETEVE, TË NAFTËS GAZIT TË LENGSHËM PËR NGROHJE TË KOPSHTEVE TË BASHKISË PËRMET DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE, PËR AUTOMJETET MZSH, AUTOMJETET E NDËRMARRJES SË PASTRIM GJELBËRIMIT, LËVIZJEN E PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PYJOR, PËR MJETET E BORDIT TË KULLIMIT DHE MJETET E PUNËS PËR RRUGËT RRURALE.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____/____/2025, mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Sasia e harxhimit të karburantit për automjetin e administrates, Policisë Bashkiake, automjetet e NJA etj, të jetë 15000 litra në vit.
2. Sasia e harxhimit të karburantit për automjetet e Ndërmarrjes së Pastrim Gjellbërimit të jetë 23500 litra në vit.
3. Sasia e harxhimit të karburantit për Automjetet e MZSH, të jetë 4500 litra në vit.
4. Sasia e harxhimit të karburantit për Emergjencat Civile, të jetë 2000 litra në vit
5. Sasia e harxhimit të karburantit për lëvizjen e punonjësve të shërbimit pyjor të jetë 1800 litra në vit.
6. Sasia e harxhimit të karburantit për mjetet e Bordit të Kullimit të jetë 12000 litra në vit.
7. Sasia e harxhimit të karburantit për mjetet e punës për Rrugët Rrurale të jetë 13000 litra në vit.
8. Sasia e harxhimit të naftës për kaldajën e Kopshtit Nr.2 të jetë 3200 litra për sezonin 1 Janar - 15 Mars 2026 dhe 15 Nëntor - 31 Dhjetor 2026.
9. Sasia e harxhimit të gazit të lëngshëm për kaldajën e shkollës Meleq Gosnishti të jetë 9600 litra për sezonin 1 Janar - 15 Mars 2026 dhe 15 Nëntor - 31 Dhjetor 2026.
10. Për institucionet dhe Nj.Administrative në varësi të Bashkisë të cilat nuk kanë në inventarin e tyre të mjeteve themelore automjete, autorizohet Kryetari i Bashkisë, të lidh kontrata, me mjete private të punonjësve të këtyre institucioneve.
11. Sasi e karburantit për automjetin “Biblioteka lëvizës” të jetë 250 litra në vit.
12. Sasi e karburantit për automjetin “Kamionçinë” tip GAZ të jetë 1000 litra në vit.
13. Shpenzimet do të përballohen nga buxheti i vitit 2026.

14. Për zbatimin e këtij vendimin garkohet Drejtoria e Financë Buxhetit Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve Mbeshtetese..
15. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes dhe i shtrin efektet financiare nga data 01.01.2026 – 31.12.2026.

KRYETARI I BASHKISE

Alma HOXHIA



RELACION

Për sasinë e harxhimit të karburantit të automjeteve dhe të naftës për ngrohje të kopëzimeve të bashkisë përmet dhe njësi administrative, për automjetet mzh, automjetet e ndërmarrjes së pastrimit gjelbërimit, lëvizjen e punonjësve të shërbimit pyjor, për mjetet e bordit të kullimit dhe mjetet e punës për rrugët rrurale.

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligji 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligj nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë".

1. Sasia e harxhimit të karburantit për automjetin e administrates Policisë Bashkiake, Automjetet NJA etj, të jetë 15000 litra në vit.
 - Automjetet që shërbejnë për lëvizjen e administrates së bashkisë 10200 litra.
 - Automjetet që shërbejnë për lëvizjen e administrates në Nj Administrative 4800 litra.Sasi e karburantit për këtë strukturë nuk ka ndryshim nga viti i kaluar.
Dy mjetet e administratës gjatë vitit 2025 janë përdorur dhe nga struktura të tjera të bashkisë për lëvizjen e punonjësve, kjo gjë parashikohet të ndodhë edhe gjatë vitit 2026 për plotësimin e nevojave të bashkisë në tërësi dhe ofrimin e shërbimit ndaj komunitetit.
Nuk ka ndryshim nga viti 2025
2. Për të siguruar internerarin ditor të ngarkim - shkarkim të mbetjeve urbane, inerte, dege, barera të ndryshme për sektorin e pastrimit si dhe punime, mirmbajtje në sektorin e gjelbërimit gjatë vitit 2026 duke u bazuar në normativat e harxhimit për çdo mjet duhen 23500 (njetete e tre mijë e pesëqind) litra naftë. Për pastrimin nga mbetjet urbane mikese, plastik, karton, Inerte, Voluminoze, të gjelberta në bashkinë Permet janë 213 kontiniere me permasa 124 me 1.1 m³, 69 me 1 m³, 20 me 0.5 m³. Pika grumbullimi 164 mbetjesh urbane, në keto pika gjenden dhe mbetje të ndryshme si inerte, voluminoze, të gjelberta. Sasia e karburantit për vitin 2026 është ulur me rreth 4340 litra, kjo për faktin se mjeti teknologjik Mercedes Benz 802 i cili kishte dhe normativen më të lartë të harxhimit, do të zëvendësohet me një mjet të ri teknologjik me karakteristika të njëjta me mjetin Mitsubishi.

- Mjeti Teknologjik Mitsubishi

Mjeti Teknologjik Mitsubishi i duhen në vitin 2026 konsum karburanti naftë rreth 11000 litra. Me poshtë një detajim për çdo Njësi Administrative.

Permet-Vend depozitim Piskove-Permet 24 km

Per vitin 2026 mjetit i duhen 96 km dite *365 dite të vitit = 35040 km në vit

Në 100km = 18 litra, në 35040 km në vit i duhen 6307.2 litra për pastrimin e qytetit.

Në vite për heqjen e mbetjeve në Njësine Administrative Carshove duhen :

9408 km në vite

Në 100 km = 18 litra, në 9408 km në vite i duhen 1693 litra karburant në vite.

Në vite për heqjen e mbetjeve në Njësine Administrative Petran duhen :

13152 km në vite

Në 100 km = 18 litra, në 13152 km në vite i duhen 2367 litra karburant në vite.

Ne vite per heqjen e mbetjeve ne Njesine Administrative Piskove duhen :
3600 km ne vite
Ne 100 km= 18 litra,ne 3600 km ne vite i duhen 648 litra karburant ne vite



- **Mjeti Vetshkarkues 813**

Mjeti Kamion Vetshkarkues 813 per heqje mbetje urbane,voluminoze,inerte te gjelberta i duhen ne vitin 2026 konsum karburanti nafte rreth 5300 litra. Me poshte nje detajim per cdo Njesi Administrative.

Njesia Administrative Petran

18432 km ne vite

Ne 100 km= 20 litra,ne 18432 km ne vite i duhen 3686 litra karburant ne vite.

Njesia Administrative Piskove

8064 km ne vite

Ne 100 km= 20 litra,ne 8064 km ne vite i duhen 1620 litra karburant ne vite.

- **Mjeti Mercedes-Benz (veteshkarkues)**

Mjeti Fusha I duhen ne vitin 2026 konsum karburanti nafte 1104 litra.

Detajuar sipas grafikut:

Qytet –Periferi-Njesi aministrative – Vend depozitim Piskove

Pastrim mbetje te gjelberta,inerte,voluminoze

Ne varesi te ngarkeses diteve, ne vite $230 \text{ dite} \times 40 \text{ km} \times 12 \text{ litra} / 100 \text{ km} = 1104 \text{ litra}$ ne vit.

- **Mjeti Vinç IVEKO**

Mjeti IVEKO I duhen ne vitin 2026 konsum karburanti nafte 2400 litra.

Detajuar sipas grafikut:

Sherbime te ndryshme ne Sektorin e Pastrim Gjelberimit(krasitje ne peme te larta,vendosje dekorit ne rast festash,,rregullim drita rrugor ne qytet ,njesi administrative,shkolla,kopeshte),me nje mesatare vjetore ne baze te parashikimeve duhen:

Ne muaj 10 here $\times 2.5 \text{ ore} = 25 \text{ ore}$ ne muaj

$25 \text{ ore} \times 12 \text{ muaj te vitit} = 300 \text{ ore}$ ne vit.

$300 \text{ ore} \times 8 \text{ litra} = 2400 \text{ litra}$ karburant ne vit.

- **Mjeti JCB-Volvo**

Mjeti JCB-Volvo I duhen ne vitin 2026 konsum karburanti nafte 2268 litra.

Detajuar sipas grafikut:

Per Mirmbajtje fushen e mbetjeve Piskove ku kryhen proceset e ndryshme si, shtyrje,ngjeshje,mbulim me dhe te mbetjeve urbane, ky process kryhet 6 here ne muaj. Pastrim nga inertet ne PGM te ndryshme dhe ngarkim ne Kamion.

Ne muaj 6 here $\times 3.5 \text{ ore pune} = 21 \text{ ore pune}$ ne muaj

$21 \text{ ore} \times 12 \text{ muaj te vitit} = 252 \text{ ore}$ ne vit.

$252 \text{ ore} \times 9 \text{ litra} = 2266 \text{ litra}$ karburant ne vit.

- **Makina Korrese bari te Sektorit te Gjelberimit**

Ne muaj per Dekorim shkurresh ,peme,Korrje bari per mirmbajtje sistemim te siperfaqeve te gjelberuar, varreza, rruge lagje, park ne qytet dhe periferi ne periudhe mars - tetor .

Ne muaj $160 \text{ litra} \times 8 \text{ muaj} = 1280 \text{ litra}$ karburant ne vit.



- Mjeti Freze i Sektorit të Gjelberimit

Per kryerjen e shërbimeve të ndryshme si punim ujitje në sipërfaqe ku nuk kemi sistem ujitje lagje dhe periferi qyteti duhet një mesatare vjetore.

25 litra në muaj * 6 muaj = 150 litra naftë në vit.

3. Sasia e harxhimit të karburantit për Automjetet e MZSH, të jetë 4500 litra në vit. Sasia e karburantit për vitin 2026 do të rritet me 500 litra.

Gjatë vitit 2025 struktura e MZSH (Zjarrfikses) është përballur me situatë të jashtëzakonshme sidomos gjatë periudhës së verës. Përveç situatave në Bashkinë e Permetit kjo strukturë ka ofruar ndihmën e saj dhe në bashkitë fqinje (Delvine, Finiq, Dropull, Gjirokaster, Tepelene dhe Kelmend).

Sasia e karburantit që duhet të planifikohet për vitin 2026 mendojmë të jetë 4500 litra afërsisht 375 litra në muaj bazuar në harxhimin faktik të dy viteve të fundit. Ky karburant parashikohet të harxhohet nga dy automjete zjarrfikse (MAN, Renault), një automjet shpëtimi dhe një mjet autoveture për transport të personelit në zjarre të mëdha, inspeksione etj.

Krahasuar me vitin 2025 kemi planifikuar një rritje prej 500 litra duke u bazuar dhe në harxhimin faktik të këtij viti. Makina tip Renault, 5500 kubik, normativën e harxhimit të karburantit e ka 25 l/100 km dhe 25 l/op me pompe në raste zjarri.

Stacionit të MZSH i është shtuar një mjet i ri MAN, 6500 kubik, normativën e harxhimit të karburantit e ka 25 l/100 km dhe 25 l/op me pompe në raste zjarri. Nevoja për një rritje prej 500 litra vjen dhe si rezultat i parashikimit të rritjes së kërkesave për ndërhyrje në raste zjarri nga ana e bashkive fqinje duke qenë se flota jonë është e re, si dhe zgjerimit të territorit në rastet e shpëtimit të njerzve (turiste) në territorin e bashkisë Permet.

4. Për këtë vit parashikohet një sasi prej 2000 litra për Emergjencat Civile. Kjo sasi do të përdoret në rastet emergjente kryesisht në ndërhyrjet që kryhen nga Reparti i Xhenjos, etj. Për vitin 2026 parashikohet të kryhet shkëmbimi i shkëmbinjve në fshatin Zhepe dhe fshatin Qilarish i Vogel, raste të cilat janë konstatuar dhe është parashikuar që me ndërhyrjen e Repartit të Xhenjos të ndërhyet në fillim të vitit 2026, kjo në varesi dhe të gadishmerisë të këtij reparti.

5. Sasia e harxhimit të karburantit për lëvizjen e punonjësve të shërbimit pyjor të jetë 1800 litra në vit.

Me VKM Nr. 433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve e Kullotave Publike", pyjet në pronësi të ishkomunave" dhe VKM nr.398 dt.20.05.20 pyjet dhe kullotat që administroheshin nga ish DSHP kaluan në pronësi të Bashkive përkatëse. Mbështetur në këtë vendim dhe bazuar në dixhitalizimin e hartave të kryer për regjistrimin e pasurisë pranë ZRPP, Bashkia e Permetit ka një sipërfaqe të përgjithshme pyjore dhe kullimore prej 18 433 Ha nga të cilat:

- Pyje 10771 ha
- Kullota 7033 ha
- Sipërfaqe boshe 18 ha
- Djerr 20 ha
- Inproduktive 110 ha
- Shkëmbore 482 ha

Struktura e pyjeve dhe kullotave e ngritur pranë Bashkisë Permet operon me një personel prej 14 veta nga të cilat 11 punonjës shërbejnë në terren, një përgjegjës për pyjet dhe kullotat, një specialist për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave si dhe një sanitare.

Pra sic shihet dhe nga te dhenat e mesiperme terreni i pyje-kullotave qe mbulon Bashkia Permet eshte nje terren kodriont-malor i shperndare nga qyteti i Permetit ne nje distance deri ne 100 km ne zonen e Dangellise dhe te parkut Bredhi i Hoteves. Ne keto kushte kontrolli mbrojtja dhe menaxhimi i fondit pyjor dhe kullisor behet dhe me i veshire ne kuadrin dhe te mospasjes dhe te nje mjeti levizes.

Per kontrollin, menaxhimin dhe inspektimin e te gjithë territorit, duke pare dhe vitet e kaluara do te duhet nje sasi karburanti perj 1800 litra ne vit. Referuar analizes se bere nga Sek. Pyje Kullota dhe konsumit faktik te vitit 2025 sasia per vitin 2026 eshte ulur me 500 litra.

6. Sasia e harxhimit të karburantit për mjetet e Bordit të Kullimit dhe Rrugët Rurale të jetë 25000 litra në vit. Sasi e karburantit për këtë strukturë eshte ulur me 5000 litra nga viti i kaluar. Kjo sasi eshte ulur ne strukturen e Rugeve Rurale per shkak te permiresimit te dy akseve rrugore rurale ato te fshatit Qilarisht dhe Leuse, si dhe permiresimit qe do ti behetgjate vitit 2026 rruges se fshatit Benje nga ana e projektit qe do te financohet nga Programi Italo- Shqiptar i Konvertimit të Borxhit – IADSA.

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 27 “Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit” pika 1, “Bashkitë janë përgjegjëse për administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”, Ligjin nr.24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit” datë 09.03.2017, ju relatojme si më poshte:

Ligji ngarkon me përgjegjësi bashkinë dhe Kryetarin e saj që në zbatim të funksioneve të veta të marrë masa organizative për të kryer shërbimet, për ti ardhur në ndihmë komunitetit duke përdorur me efikasitet të lartë të gjithë mjetet dhe burimet materiale që ka në dispozicion duke ritur koficientet e përdorimit dhe shfrytëzimit të tyre.

Në zbatim të këtyre përgjegjësi nga ana e jonë është punuar që me mjetet që kemi në dispozicion, pamvarësisht kohës së përdorimit të tyre dhe amortizimit fizik, ti mirëmbajmë dhe të risim koficientin e shfrytëzimit si atë të gadishmërisë për punë por dhe shfrytëzimin e kohës së punës. Si rezultat i kësaj pune ne kemi një shfrytëzim gjithë vjetor të këtyre mjeteve, duke ju përgjigjur në çdo kohë kërkesave të komunitetit.

Në inventarin e mjeteve mekanike janë dy mjete të rënda (Volvo me zinxhir, eskavator JCB) dhe Kamion tip Man.

Më konkretisht mjeti eskavator VOLVO ECR88, me një koficient gadishmërie 80% dhe shfrytëzim të kohës së punë gjithëvjetore 80%, planifikojmë sasinë prej rreth 10400 litra gasoil për 197 ditë pune. Mesatarisht në muaj referuar dhe një analize bërë për vitin 2024 dhe 2025, orët e punës për punimet e kryera në Sek. Bordit të Kullimit janë 60 op/muaj, për kryerjen e punimeve për sistemim perrenjsh për te evituar permbytje dhe hapje pastrim kanale ujites dhe kullues në të gjithë territorin e bashkisë Përmet. Në Sek. Rugeve Rurale mesatarisht orët e punës për një muaj janë 33 op/muaj, për kryerjen e punimeve, hapje dhe pastrim kanali anesor i rruges, skarifikim rruge, germim dhe ngarkim të materialeve inerte për mbushjen e rrugeve etj. Normativa për orë pune është 9 litra.

Mjeti fadrom JCB AFMT 56, me një koficient gadishmërie 70% dhe shfrytëzim të kohës së punës 00% planifikojmë sasinë prej rreth 8300 litra për 175 ditë pune. Mesatarisht në muaj referuar dhe një analize bërë për vitin 2024 dhe 2025, orët e punës për punimet e kryera në Sek. Bordit të Kullimit janë 40 op/muaj, për kryerjen e punimeve për sistemim perrenjsh për te evituar permbytje dhe hapje pastrim kanale ujites dhe kullues në të gjithë territorin e bashkisë Përmet. Në Sek. Rugeve Rurale mesatarisht orët e punës për një

muaj janë 33 op/muaj, për kryerjen e punimeve, hapje dhe pastrim kanali anesor i rruges , skarifikim rruge, etj. Normativa për orë pune është 9.5 litra.



Mjeti kamion tip MAN me vinç, me një koeficient gadishmërie 72% dhe kilometra të përshkuara mesatarisht në një ditë 110, planifikojmë sasinë prej 6300 litra për 175 ditë pune. Mesatarisht në muaj referuar pas një analize bërë për vitin 2024 dhe 2025, kilometrat për punimet e kryera në Sek. Bordit të Kullimit janë 290km/muaj, kryesisht për transportin e mjetit Volvo për punimet që kryhen në territorin e bashkisë Permet. Në Sek. Rrugeve Rurale mesatarisht kilometrat për një muaj janë 1457km/muaj, për kryerjen e punimeve, si transport materiali inert për mbushje të rrugëve, transport mjeti Volvo, etj. Sasite e mësipërme të harxhimit të karburantit, duke u nisur dhe nga përvoja e viteve të kaluara janë të mjaftueshme për këte park mjetesh që kemi aktualisht në inventar. Dhe shtimi i mjetit të ri (kamion me vinç) në Sek. Bordit të Kullimit nuk parashikohet të sjellë rritje të konsumit të karburantit në këtë sektor pasi karakteristikat e vendosura për këtë mjet janë të njëjta me mjetin që aktualisht përdoret nga Sek. Bordit të Kullimit. Normativa për kilometra është 30 litra.

7. Sasia e harxhimit të naftës për kaldajën e Kopshtit Nr.2 të jetë 3200 litra për sezonin 1 Janar - 15 Mars 2026 dhe 15 Nentor - 31 Dhjetor 2026. Sipas monitorimit që i është bërë kaldajës tek Kopshti Nr.2 rezultoi se ajo harxhon 5 l/orë naftë.
8. Për funksionimin e kaldajës ne shkollen 9-vjecare "Meleq Gosnishi". Sipas katalogut të vendosur në dispozicion nga firma zbatuese, konsumi mesatar i kaldajës është 8 litra në orë. Për gjithë kohe zgjatjen e mesimit parashikohet të konsumohen 120 litra cdo ditë. Për sezonin e dimrit, 1 Janar - 15 Mars 2026 dhe 15 Nentor - 31 Dhjetor 2026, ku janë maksimalisht 80 ditë mesimi, nevojitet një sasi gazi i lëngshëm prej 9600 litra. Nuk ka ndryshim nga viti 2025.
9. Sasi e karburantit për automjetin "Bibloteke levizes", referuar përdorimit dhe normativave të harxhimit të saj për vitin 2025, nevojitet një sasi prej 250 litra karburant për vitin 2026. Nuk ka ndryshim nga viti 2025.
10. Sasi e karburantit për automjetin "Kamioncine" GAZ (MAPCULT), referuar përdorimit dhe normativave të harxhimit të saj për vitin 2025, nevojitet një sasi prej 1000 litra karburant për vitin 2026. Ky mjet përveçse në funksion të projektit përdoret nga ana e sektorit të mirëmbajtjes dhe për transporte të ndryshme të materialeve apo pajisjeve në raste aktiviteteve. Nuk ka ndryshim nga viti 2025.
11. Për institucionet dhe Nj. Administrative në varësi të Bashkisë të cilat nuk kanë në inventarin e tyre të mjeteve themelore automjete , autorizohet Kryetari i Bashkisë, të lidh kontrata, me mjete private të punonjësve të këtyre institucioneve.
12. Shpenzimet do të përballohen nga buxheti i vitit 2026.

PREGATITI

ING. FREDI LIPE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ dt _____ / _____ /2025.

PËR

MIRATIMIN E HARTËS SË LINJAVE TË TRANSPORTIT TË PUNONJËSVE ARSIMORE QË
PUNOJNË DHE TË NXËNËSVE QË MËSOJNË JASHTË VËNDBANIMIT TE TYRE PËR
VITIN MËSIMOR 2025-2026 NË BASHKINË PËRMET.

Këshilli Bashkiak Përmet i mbledhur më datën ____/____/2025 Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 dt 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 69/2012 Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, VKM Nr. 89, datë 14.2.2018 “Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve” i ndryshuar, pika 2 e Vendimit nr. 239, datë 24.4.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 119, datë 1.3.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit” ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 5, të Ligjit nr. 8308 datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar, Udhëzimit Nr.15, datë 24.07.2007 “ Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” neni 2 pika 27. germa b, Udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brënda vëndit” shkresës nr 3857 prot. date: 17.11.2025 të Zyrës Vendore Arsimore me lëndë: “Për miratimin e hartës së linjave për transportin e punonjesve arsimore që punojnë dhe te nxënësve që mësojne jashtë vëndbanimit të tyre, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga zyra e Shërbimeve Publike dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

VENDOSI:

- 1- Të miratojë hartën e linjave për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vëndbanimit të tyre për vitin mësimor 2025-2026 në Bashkinë Përmet sipas **Aneksit 1** bashkëlidhur dhe është pjesë përbërëse e tij. Distanca të linjave të cilat kufizohen me Bashkinë Këlcyre janë marë deri në kufirin midis dy bashkive në vëndin e quajtur (Rrapi i Kuqarit) në kordinatën: **KRGJSH E: 520332.65 N: 4461794.72**
- 2- Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Arsimit Kulturës, Çështjeve Sociale, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Sektori i Tatimit-Taksave Aseteve dhe Liçensave dhe Drejtoria e Zhvillimit dhe Planifikimit të Territorit.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKINË

Alma HOXHA



Aneksi 1.

ZVAP Përmet-Këlcyrë

HARTA E LINJAVE PËR TRANSPORTIN E PUNONJËSVE ARSIMORË QË PUNOJNË DHE TË NXËNËSVE QË MËSOJNË JASHTË VËNDBANIMIT TË TYRE PËR VITIN 2025-2026 BASHKIA PËRMET.

Nr	Emertimi i linjave	Distanca	Nr. mësuesve	Nr. nxënësve
	Nënlinja			
1/1	Përmet-Petran	8.5	5	1
1/2	Përmet-Gjinkar	7.5	2	
1/3	Përmet-Kaludh	14	2	
1/4	Përmet-Illar Munushtir	18	8	
1/5	Strëmbec-Illar Munushtir	4		3
1/6	Tabor-Illar Munushtir	3		6
1/7	Kaludh-Illar Munushtir	6		3
1	Linja nr.1 Përmet-Çarshovë		2	
2/1	Kaludh-Përmet	14	2	1
2/2	Draçovë-Përmet	21		1
2/3	Strëmbec-Përmet	17	2	4
2/4	Delvinë-Përmet	23		1
2/5	Petran-Përmet	8.5	1	
2/6	Badlonjë-Petran	4		2
2/7	Badlonjë-Përmet	6		2
2/8	Qilarisht-Përmet	5		25
2/9	Lipivan-Petran	6.5		5
2/10	Bënjë-Përmet	7.5		6
2/11	Gjinkar-Përmet	7.5		3
2/12	Zhepë-Përmet	25		3
2/13	Ogdunan-Përmet	25		3
2/14	Munushtir-Përmet	13		1
2/15	Lëshicë-Përmet	6		4
2/16	Pëllumbar-Përmet	19		1
2/17	Gostivisht-Përmet	26		2
2/18	Gosnisht-Përmet	11		1
2	Linja nr.2 Çarshovë-Përmet			1
3/1	Përmet-Buhal	6.5	1	
3/2	Përmet-Kosinë	8	2	
3/3	Përmet-Rapckë	11.5	1	
3/4	Përmet-Piskovë	10	11	
3/5	Rapckë-Piskovë	4.5		1
3/6	Pacomit-Piskovë	3		5
3/7	Përmet-Pacomit	13.5	2	
3/8	Përmet-Sukë (Kufiri me Bashkinë Këlcyrë)	13.5	9	
3/9	Përmet-Toshkës (Kufiri me Bashkinë Këlcyrë)	13.5	1	
3/10	Kosinë-Këlcyrë (Kufiri me Bashkinë Këlcyrë)	7	1	
3/11	Kosovë-Këlcyrë (Kufiri me Bashkinë Këlcyrë)	24	1	
3/12	Kosovë-Ballaban (Kufiri me Bashkinë Këlcyrë)	24	1	
3/13	Frashër-Këlcyrë (Kufiri me Bashkinë Këlcyrë)	35	1	
3/14	Piskovë-Këlcyrë (Kufiri me Bashkinë Këlcyrë)	3.5	1	
3/15	Përmet-Këlcyrë (Kufiri me Bashkinë Këlcyrë)	13.5	13	
3/16	Leusë-Përmet	2.5	1	4
3/17	Leusë-Ballaban (Kufiri me Bashkinë Këlcyrë)	16	1	
3/18	Leusë-Këlcyrë (Kufiri me Bashkinë Këlcyrë)	16	1	
3/19	Lipë-Përmet	1.5		1
3/20	Rapckë-Ballaban (Kufiri me Bashkinë Këlcyrë)	8	1	
3/21	Rapckë-Sukë (Kufiri me Bashkinë Këlcyrë)	8	1	
3/22	F. Alipostivan-Këlcyrë (Kufiri me Bashkinë Këlcyrë)	14.5		1
TOTALI			74	91

BASHKIA PËRMET

Sheshi "Abdyl Frashëri"; tel.+35581322254; web:www.bashkiapermet.gov.al; e-mail:info@bashkiapermet.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

DIREKTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, KULTUROR, TËRHEQJEVE TËRREJTE, KËRKEVE DHE LICENCAVE

Përmet më ____/____/2023

RELACION

Për

Miratimin e hartës së linjave të transportit të punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vëndbanimit të tyre për vitin mësimor 2023-2024 në Bashkinë Përmet.

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Përmet

Të nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 dt 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 69/2012 Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, VKM Nr. 89, datë 14.2.2018 "Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve" i ndryshuar, pika 2 e Vendimit nr. 239, datë 24.4.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 119, datë 1.3.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vëndbanimit" ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 5, të Ligjit nr. 8308 datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore" i ndryshuar, Udhëzimit Nr.15, datë 24.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" neni 2 pika 27. germa b, Udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brënda vëndit", shkresës nr 3857 prot. date: 17.11.2025 të Zyrës Vendore Arsimore me lënde: "Për miratimin e hartës së linjave për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vëndbanimit të tyre, të institucioneve arsimore në territorin e Bashkisë Përmet hartoi këtë relacion si më poshte:

Përkufizime të përgjithëshme referuar: Rregullores "Për kushtet dhe rregullat për transportin rrugor të nxënësve të arsimit Parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve":

Për qëllime të plotësimit të kushteve dhe të përcaktimit të rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve përdoren përkufizimet e mëposhtme:

- a) "Transportues ose subjekt transporti", personi fizik ose juridik i licencuar për të tretë, sipas legjislacionit në fuqi, ose i pajisur me certifikatë për llogari të vet për operatorët e transportit për llogari të vet.
- b) "Mjet transporti shkollor", automjeti që ka karakteristika teknike të vendosura sipas kësaj rregulloreje dhe përkufizimeve të përcaktuara në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.
- c) "Institucion arsimor parashkollor profesional parauniversitar dhe i lartë, publik apo privat", institucioni sipas legjislacionit në fuqi për arsimin parashkollor, arsimin bazë, ku përfshihet arsimi fillor dhe arsimi i mesëm i ulët, arsimi i mesëm i lartë, profesional dhe arsimi i lartë, publik dhe privat.
- ç) "Licencë", akti administrativ i lëshuar për një periudhë të caktuar kohe, i vlefshëm për të ushtruar veprimtari transporti udhëtarësh.
- d) "Certifikatë", dokumenti që mbahet në mjet gjatë udhëtimit dhe që:
- i) shoqëron licencën për rastet e transporteve rrugore që janë subjekt licencimi;

Sheshi "Abdyl Frashëri"; tel.+35581322254; web:www.bashkiapermet.gov.al; e-mail:info@bashkiapermet.gov.al



ii) i jep të drejtën një institucioni arsimor për transportin për llogari të vet të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve.

dh) "Shërbimet e rregullta të specializuara", shërbimet që sigurojnë transportin:

i) shtëpi – institucion parashkollor (kopshti i fëmijëve) dhe anasjelltas, sipas përcaktimeve të pikës 7.4, të kësaj rregulloreje;

ii) shtëpi – institucion shkollor ose universitet dhe anasjelltas, i parauniversitarëve dhe i studentëve, sipas përcaktimeve të pikës 7.4.

e) "Shërbime transporti të rastit", ato shërbime transporti që nuk i përgjigjen përkufizimit të shërbimeve të rregullta të specializuara..

ë) "Transport për llogari të vet", transporti i kryer për qëllime jotregtare dhe jofitimprurëse nga një institucion arsimor, me kusht që:

i) veprimtaria e transportit të jetë vetëm një veprimtari ndihmëse për institucionin;

ii) mjetet e përdorura të jenë pronë e institucionit ose të jenë të blera me këste prej tij, ose të jenë objekt i një kontrate qiramarrjeje afatgjatë dhe të drejtohen nga një punonjës apo anëtar i institucionit arsimor.

f) "Dokument kontrolli", licenca, certifikata, fleta ose libri i udhëtimit, kontrata e udhëtimit dhe çdo dokument që i përket automjetit, drejtuesit të mjetit dhe operimit në rrugë, që mbahen në origjinal ose kopje e njësuar me origjinalin në bordin e automjetit gjatë gjithë udhëtimit.

4. Licenca dhe certifikata

4.1 Janë subjekt licencimi dhe certifikimi personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e transportit për:

a) shërbimet e rregullta, përfshirë shërbimet e rregullta të specializuara për nxënësit e arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe studentët;

b) shërbimet e rastit;

c) transportet për llogari të vet, të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve.

4.2 Licenca lëshohet në bazë të nenit 5, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 325, datë 19.3.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë", të ndryshuar.

4.3 Shërbimet e rregullta, përfshirë shërbimet e rregullta të specializuara dhe shërbimet e rastit, janë subjekt i licencës së lëshuar nga autoriteti kompetent sipas pikës 5, të kësaj rregulloreje.

4.4. Autoriteti kompetent i lëshimit të licencës lëshon certifikata për çdo mjet që është në përdorim, edhe nëse këto mjete janë pronë e institucionit arsimor apo të marra me qira.

4.5. Çdo mjet është i pajisur edhe me certifikatën e operimit, e cila është dhe pjesë përbërëse e kontratës së lidhur ndërmjet transportuesit dhe institucionit.

4.6. Shërbimet e rregullta, përfshirë shërbimet e rregullta të specializuara të transportit të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve, janë subjekt kontrolli i certifikatës së operimit dhe i kontratës së lidhur ndërmjet subjektit transportues dhe institucionit për të cilin kryhet shërbimi.

4.7. Certifikata për llogari të vet është subjekt i kryerjes së transportit për llogari të vetë institucionit.

4.8. Shërbimet e transportit të rastit (turistike) janë subjekt kontrolli i dokumentit të udhëtimit dhe i kontratës së lidhur ndërmjet subjektit transportues të licencuar për këtë lloj transporti dhe agjencisë turistike të udhëtimit.

5. Autoriteti kompetent për lëshimin e licencës/certifikatës

5.1. Autoriteti/autoritetet kompetent/e për lëshimin e dokumenteve për pranimin në profesion dhe hyrjen në tregun e transportit rrugor të transportuesve që kryejnë transport të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve caktohen sipas legjislacionit në fuqi.

6. Kushtet që duhet të plotësojë mjeti i transportit

6.1 Mjetet e transportit për shërbimin e rregullt dhe të rastit të transportit të institucioneve arsimore parashkollë, profesionale parauniversitare dhe universitare duhet, në çdo kohë, të jenë të pajisura me certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, të lëshuar në përputhje me rregjistracionin në fuqi.

6.3 Transporti i nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe i studentëve kryhet vetëm me autobusë, me përjashtim të rasteve të zonave ku infrastruktura rrugore nuk përmbush kriteret e udhëtimit me autobus dhe numri i fëmijëve të institucioneve arsimore parashkollë dhe i parauniversitarëve është më i vogël se 8 (tetë) persona, atëherë në këto raste lejohet përdorimi i autoveturës me 8+1 vende.

6.4 Përdorimi i autoveturave me 8+1 vende për transportin e nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar bëhet vetëm me miratimin e bashkisë.

6.5 Automjetet që bëjnë transportin e nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve duhet të kenë të shkruar dukshëm, në mënyrë të rregullt, brenda xhamit të përparmë, me ngjyrë të zezë, fjalët "TRANSPORT SHKOLLOR". Në pjesën e pasme dhe anash vendoset logoja me shenjë e fëmijëve të shkollës, sipas fig. II 304, dhënë në vendimin nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar. Në këto mjete nuk duhet vendosur asnjë lloj reklame.

6.10. Asnjë subjekt nuk mund të japë ose të marrë me qira një automjet të destinuar për shërbime të rregullta të specializuara të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve, nëse subjekti nuk është i pajisur me licencë për të tretë në transportin e udhëtarëve.

6.11. Certifikata e operimit, e lëshuar për një automjet të destinuar për shërbimet e rregullta të specializuara për parashkollorët, parauniversitarët dhe studentët, lëshohet në emër të subjektit të transportit.

6.12. Certifikata e operimit, e lëshuar për një automjet të destinuar për shërbimet e rregullta të specializuara për nxënës të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe studentëve, lëshohet me afat pesëvjeçar dhe nuk është e transferueshme. Në certifikatën e operimit vendoset itinerari që përshkruan automjetin, e shoqëruar me vendndalimet përkatëse.

7. Drejtuesi i mjetit

7.1 Drejtuesi i mjetit të certifikuar për transport të rregullt të specializuar ose për llogari të vet, për nxënës të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe studentët duhet:

- a) të ketë kryer/përfunduar të paktën arsimin e mesëm;
- b) të jetë pajisur me leje drejtimi të kategorisë D1, D1E, D dhe DE pas vitit 2010;
- c) të jetë pajisur me certifikatën e aftësisë profesionale përkatëse (CAP);
- ç) të ketë reputacion dhe sjellje të mirë.

8.6 Në çdo udhëtim jashtë qytetit, për arsye ekskursioni ose didaktike, duhet të jetë i pranishëm përfaqësuesi i institucionit arsimor.

9. Koha e udhëtimit

Koha e udhëtimit për në dhe nga institucioni i edukimit të fëmijëve dhe parauniversitarëve, Brenda qytetit nuk i kalon 50 minuta, ndërsa në zonat rurale kjo kohë mund të shtrihet deri në 70 minuta.

10. Lidhja e kontratës për transport të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe universitar

10.1 Njësitë e qeverisjes vendore dhe njësitë arsimore vendore për arsimin parashkollor publik dhe privat, parauniversitar publik e privat, profesional publik e privat dhe institucionet e arsimit të lartë publike dhe private, janë përgjegjëse për lidhjen e kontratës ndërmjet institucionit dhe organizatorit të transportit për nxënës të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve.

10.2 Kontrata duhet të përmbajë elementet e përcaktuara nga Kodi Civil dhe elementet shtesë të përcaktuara, si më poshtë vijon:

- a) oraret e nisjes dhe të kthimit;
- b) itinerarin e përcaktuar të mjetit shkollor;
- c) vendndalimet e paracaktuara gjatë itinerarit;

c) kontrollgjatjen e ndërtimit.

10.3 Një kopje e kontratës së nëndëruar është pjesë e dokumenteve të nevojshme për qarkullim dhe i paraqitet organeve të kontrollit në rrugë sa herë kërkohet prej tyre.

11. Kadarri ligjor dhe institucional

11.1 Referuar Vendimit nr. 239, datë 24.4.2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 119, datë 1.3.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjëseve arsimorë që punojnë dhe të ndihmëve që mirëtojnë jashtë vendbanimit" pika 1 gërma "b" citohet dhe pika 2 citohet: "Zyra vendos të arsimin përsonveritar (ZVAP), bazuar në informacionin që marrin nga drejtuesit e LAP-ve publike, dërgojnë, praet njërive të vetëqeveritjes vendore, të dhëna për numrin e fëmijëve/ndihmëve dhe të punonjëseve arsimorë të tyre, që planifikohen të përfundojnë nga shërbimi i transportit, sipas kërkesave të përmbledhura në pikën 1 të këtij vendimi. Njësitë e vetëqeveritjes vendore numtojnë, hetojnë mungjt të tyre, llogar dhe orarët e transportit nevojshetë për realizimin e këtij shërbimi në vitin e ardhshëm budhetor, duke u bazuar në informacionin që u dërgohet nga ZVAP-t dhe shëruat e arsimi profesional publik sipas kësaj pike".

11.2 Referuar Ligji Nr 139/2015 dt 17.12.2015 "Për vetëqeveritjes vendore", Ligji nr. 187/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territoreve" i ndryshuar, disonancat e ligjeve të cilat kufizohen me Bashkitë Këlcyrë just merit dori të kufizojnë ardhën dy bashkitë në vitin e ardhshëm (Borç i Kufizuar) të koordinuar: KRGJDM E. 020033.00 N. 0005704.72

Ne më sipër ju ftojme të mirëtojnë hartën e ligjeve për transportin e punonjëseve arsimorë që punojnë dhe të ndihmëve që mirëtojnë jashtë vendbanimit të tyre për vitin ndihmës 2023-2024. Bashkia Përmet sipas Artikullit 1 bashkëlidhur, me qëllim që /-ja bashkia Përmet të mirëtojë transportin e ndihmëve dhe ndihmëve të institucionit arsimor për vitin ndihmës, hetojnë territorin të Bashkisë Përmet.

Përmet: Administratori i Shërbimeve Publike: Artan BASHIRI

Përmet: Drejtori e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësi dhe Turizmit: Elina WAFI BASHIRI

Drejtori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territoreve: Ing. Lora BASHIRI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E PËRMET

P/V E N D I M

Nr. _____ datë _____. 2025

**PËR MIRATIMIN E KUOTAVE USHQIMORE PËR TRAJTIMIN E FËMIJËVE NË
ÇERDHE DHE KOPËSHITIN ME DREKË NË BASHKINË E PËRMET**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhmin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", me propozim të Kryetarit të Bashkisë :

VENDOSI:

1. Kuota ditore ushqimore për trajtimin e fëmijëve në ÇERDHE të përcaktohet në vlerën 219 lekë.
 - Vlera prej 136 lekë do të mbulohet nga prindërit
 - Vlera prej 83 lekë do të mbulohet nga Buxheti i Bashkisë.
2. Kuota ditore ushqimore për trajtimin e fëmijëve në KOPËSHT ME DREKË të përcaktohet në vlerën 266 lekë.
 - Vlera prej 136 lekë do të mbulohet nga prindërit
 - Vlera prej 130 lekë do të mbulohet nga Buxheti i Bashkisë.
3. Shpenzimet për mbulimin dhe blerjen e ushqimeve të përballohen nga buxheti i vitit 2026.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori Juridik/Prokurime, Drejtoria e Kopshteve dhe Drejtoria e Buxhet-Financë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISË
Alma HOXHA



RELACION

**PËR MIRATIMIN E KUOTAVE USHQIMORE PËR TRAJTIMIN E FËMIJËVE NË
ÇERDHE DHE KOPËSHITIN ME DREKË NË BASHKINË PËRMET**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhmin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

I propozohet Këshillit Bashkiak miratimi i kuotave ushqimore për trajtim të fëmijëve në çerdhe dhe kopësht me drekë.

Që prej muajit Nëntor të vitit 2019, Bashkia Përmet ka filluar ofrimin e shërbimit të kopështit me drekë.

Duke parë kushtet e sotme të tregut, ku çmimet e produkteve ushqimore që janë pjesë e menusë ditore në kopësht dhe çerdhe kanë pësuar rritje në vitin 2026 kuota ushqimore në çerdhe është rritur me 11 lekë dhe kuota ushqimore në kopështin me drekë është rritur 27 lekë krahasuar me vitin 2025.

Për vitin 2026 kuota që do të paguhet nga prindrit do të jetë njësoj si në vitin 2025 ndërsa rritja që ka pësuar kuota do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Përmet si më poshtë:

1. Kuota ditore ushqimore për trajtimin e fëmijëve në ÇERDHE të përcaktohet në vlerën 219 lekë.
 - Vlera prej 136 lekë do të mbulohet nga prindërit
 - Vlera prej 83 lekë do të mbulohet nga Buxheti i Bashkisë.
2. Kuota ditore ushqimore për trajtimin e fëmijëve në KOPËSHIT ME DREKË të përcaktohet në vlerën 266 lekë.
 - Vlera prej 136 lekë do të mbulohet nga prindërit
 - Vlera prej 130 lekë do të mbulohet nga Buxheti i Bashkisë.

Bashkëngjitur relacionit është dhe menuja javore për çerdhen dhe kopështin me drekë.

DREJTORESHA E KOPSHTJEVE
Manjola MEHMETI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
P./VENDIM

Nr. ____ datë ____ . ____ . 2025

Për

“Përfjashtimi nga tarifa e kopshtit dhe çerdhes me drekë fëmijët e familjeve që i përkasin këtyre kategorive: familje me shumë fëmijë, familje të komunitetit rom dhe egjiptjan, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, fëmijë që kanë statusin e jetimit, fëmijët me një prind, familje që ka binjakë.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____ .12.2025 mbështetur në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54” detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak” i ndryshuar, Ligji 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Republikën e Shqipërisë: i ndryshuar, , Ligj Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” Ligji Nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi Ligji Nr. ____/2025 “Për Buxhetin e vitit 2026”, Vendimi i KB Nr. ____ datë ____ .12.2025 “Për Buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2026” për t’u ardhur në ndihmë familjeve me shumë fëmijë familjeve të komunitetit rom dhe egjiptjan, familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, fëmijëve që kanë statusin e jetimit, fëmijët me një prind, familjeve që kanë binjakë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga specialistët dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë

VENDOSI:

1. Të miratojë përfjashtimin nga tarifa e kopshtit dhe çerdhes fëmijët që i përkasin:

a- Familjeve me shumë fëmijë. (familje që kanë 4 ose më shumë fëmijë.).

b- Familjeve të komunitetit rom dhe egjiptjan.

c- Familjeve që trajtohen me Ndhimë Ekonomike.

ç- Fëmijët që kanë statusin e jetimit.

d- Fëmijët me një prind.

e- Familjet që kanë binjakë, përfjashtohet njëri.

2. Efektet financiare fillojnë nga data 01.01.2026- 31-12.2026

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sektori i finances

4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefektura.

KRYETARI I BASHKISË

Alma HOXH

Sheshi “Abdyl Frashëri”; tel. +35581322254; bashkiapermet.gov.al e-mail: info@bashkiapermet.gov.al





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA PËRMET

RELACION

KESHILLIT BASHKIAK

PËR MET

Përmet më ____ . ____ 2025

Mbështetur në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore " neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak " i ndryshuar, Ligji Nr 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në R.Sh. i ndryshuar , Ligji Nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" ", Ligji Nr. ____/2025 "Për Buxhetin e vitit 2026", VKB Nr. ____ datë ____ .12.2025 " Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2026 për t'u ardhur në ndihmë familjeve me shumë fëmijë, familjeve të komunitetit rom dhe egjiptjan, familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, fëmijëve që kanë statusin e jetimit, fëmijët me një prind, familjet që kanë binjakë, pas verifikimit të bërë në kopshte dhe çerdhe për kategorinë e këtyre fëmijëve të cilët janë trajtuar me këtë bonus dhe janë larguar pasi fillojnë shkollën kërkojmë nga ana Juaj

Të përjashtohen nga tarifa e kopshtit dhe çerdes me drekë fëmijet që i përkasin familjeve të këtyre kategorive.

Lista me emrat e fëmijëve të cilët do të përjashtohen nga tarifa e kopshtit dhe çerdes me drekë do të dorëzohet në zyrën e Finacës nga Drejtoresha e Kopshtit.

Drejtori i Shërbimit Social

Arjana PAPAPANO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ Prot

Përmet, më ____/____/2025

**PROJEKT-VENDIM
PËR**

DHËNIE NË PËRDORIM TË FONDIT KULLOSOR, TË NJË SIPËRFAQE PREJ 0.1843 HA, NË NGASTRËN NR 27 TË EKONOMISË KULLOSORE "DHËMBEL'PËR VËNIE ANTENE TË TELEFONISË SË LËVIZËSHME, NGA SHOQËRIA "VODAFONE ALBANIA" SHA.

Nr. _____ Datë. _____ 2025

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për Qeverisjen vendore", Ligji nr. 57/2020 "Për pyjet", ligji 9693 "Për fondin kullor", ndryshuar në Ligj Nr.49/2016, VKM nr.433 dt.08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike", i ndryshuar në VKM nr.398 dt.13.05.2025, V.K.M nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të Fondit Pyjor Kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore e jodrusore pyjore", e ndryshuar, Udhëzim nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullor publik", Kërkesën nr.3127, datë 25.09.2025, të shoqërisë "Vodafone Albania" SHA, Urdhërin nr.478, datë 10.11.2025, të Kryetarit të bashkisë Përmet "Për hartimin e raportit tekniko-ekonomik, për dhënie në përdorim të sipërfaqes kullorore", Raportin e vlerësimit Tekniko-Ekonomik, hartuar nga grupi i punës ngritur me Urdhër Nr.478 datë 10.11.2025, të Kryetarit të Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, bazuar në relacionin e paraqitur nga Sektori Bujqësi-Turizëm. Këshilli i Bashkisë Përmet, në mbledhjen e datës _____,

VENDOSI

1. Miratimin e dhënies në përdorim të një sipërfaqe prej 0.1843 ha, në Ekonominë Kullorore "Dhëmbel", ngastra nr.27, e cila pozicionohet në zonën kadastrale numër 3153, me numër pasurie 257, për vendosje antene të telefonisë së lëvizëshme dhe ndërtime të tjera ndihmëse, nga shoqëria "Vodafone Albania" SHA.
2. Vlera vjetore e dhënies në përdorim me kontratë qiraje, të jetë sipas vlerësimit të raportit tekniko-ekonomik, bazuar V.K.M nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/Përdorim të Fondit Pyjor Kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore e jodrusore pyjore", e ndryshuar, shtojca nr.1, pika 7,8 dhe 11.

Sheshi "Abdyl Frashëri", tel:35581322254, email:info@bashkiapermet.gov.al, www2.bashkiapermet.gov.al

3. Pas pajisjes së Shoqërisë Vodafone Albania Sh.A, me lejen mjedisore përkatëse, do të vijohet me përpilimin e kontratës nga sektorët përkatës, ku do të përcaktohen kushtet , të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe nënshkrimin e saj nga Kryetari i Bashkisë.
4. Afati dhënies në përdorim është 9 vjet nga data e nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike, Sektori Bujqësi-Turizëm, Sektori Pyje-Kullota, Sektori Juridik.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore.

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. ____ Prot

Përmet më ____/____/2025

RELACION PËR KËSHILLIN BASHKIAK

Bazuar në:

- Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin nr. 57/2020 "Për Pyjet";
- Ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për fondin kullor";
- V.K.M nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të ish komunave/bashkive", ndryshuar në V.K.M nr.398, datë 13.05.2020.
- V.K.M nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të Fondit Pyjor Kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore e jodrusore pyjore", e ndryshuar në V.K.M.Nr.267, datë 27.04.2023
- Udhëzim nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullor publik".
- Kërkesën nr.3127, datë 25.09.2025, të shoqërisë "Vodafone Albania" SHA.
- Urdhërin nr.478, datë 10.11.2025, të Kryetarit të Bashkisë Përmet "Për hartimin e raportit tekniko-ekonomik, për dhënie në përdorim të sipërfaqes kullorë".
- Raportin e vlerësimit Tekniko-Ekonomik, hartuar nga grupi i punës ngritur me Urdhër Nr.478, datë 10.11.2025, të Kryetarit të Bashkisë.

Përmbajtja e relacionit:

Shoqëria "Vodafone Albania" SHA, në datë 25.09.2025 ka paraqitur pranë bashkisë Përmet kërkesë, të regjistruar me numër protokoll 3127, datë 25.09.2025 për vendosjen e një antene të telefonisë së lëvizëshme në afërsi të fshatit Rapckë, njësi administrative Piskovë, zona kadastrale nr.3153, me numër pasurie 257 në një sipërfaqe prej 0.1843 ha toke me status kullorë publike, nga të cilat 0.01 ha do të përdoren për vendosjen e antenës, 0.0243 ha për ndërtimin e 81 ml rrugë, për lidhjen me rrjetin rrugor egzistues dhe 0.15 ha do të përdoren për ndërtimin e linjës së re elektrike për lidhjen me rrjetin egzistues.

Bashkëngjitur kërkesës për marrje në përdorim të sipërfaqes së mësipërme, shoqëria "Vodafone Albania" SHA ka dorëzuar dhe dokumentat e mëposhtme.

1. Kopje të ekstraktit QKB të subjektit.
2. Kopje të dokumentacionit të ushtrimit të aktivitetit.
3. Prokurë
4. Plan topografik të sipërfaqes së kërkuar në shkallë 1:10000.

Sheshi "Abdyl Frashvri", tel:35581322254, email: bashkiapermet.gov.al, web: www@bashkiapermet.gov.al



5. Pamje të antenës.
6. Planimetri të antenës.
7. Gjurmën e linjës elektrike.
8. Projektin e rrugës.

Grupi i punës përbërë nga përfaqësuesit e bashkisë Permet, pas inspektimit në terren, konstaton se:

- Sipërfaqja e kërkuar ndodhet në ngastrën numër 27 të ekonomisë kullosore "Dhëmbel"
- Sipërfaqja e kërkuar ndodhet në një zonë kullosore që nuk ndikon në kullotjen e bagëtive të komunitetit lokal;
- Vendosija e antenës nuk cënon rrjedhën e ujërave, kufijtë e pronës publike apo të banorëve;
- Investimi është me ndikim pozitiv për komunitetin, për komunikimin dhe emergjencat civile;
- Kompania do të ndërtojë objektin sipas standarteve teknike dhe mjedisore në fuqi.

Përfitimet:

- Përmirësimi i mbulimit me sinjal telefonik dhe internet të zonës, e cila aktualisht ka sinjal të dobët ose të munguar.
- Të ardhura shtesë për bashkinë Permet.

Propozimi:

Në bazë të sa më sipër, propozohet që Këshilli Bashkiak i bashkisë Permet të miratojë.

- Dhënjën në përdorim për një afat 9 vjeçar të një sipërfaqe prej 0.1843 ha, të ngastrës numër 27 „Ekonomia Kullosore”Dhëmbel”,në afërsi të fshatit Rapckë,njësia administrative Piskovë.
- Përdorimi i sipërfaqes të bëhet vetëm për qëllimin e përcaktuar dhe pa të drejtë nënshfrytëzimi;
- Kompania të paguajë tarifën vjetore të përdorimit sipas përcaktimeve të këshillit bashkiak dhe kontratës përkatëse.

Duke ju falënderuar:

PËRGATITI:

Përgjegjësi i Sektorit Bujqësi-Turizëm,
Ing.Bledar Tesho

Përgjegjës i Sektorit Juridik
Enea Kushe

Sheshi "Abdyl Frashvri",tel:35581322254,emailbashkiapermet.gov.al,web:www@bashkiapermet.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
P/VENDIM

Nr. ____ datë ____ . ____ .2025

PËR

MIRATIMIN E NUMRIT, NIVELIT TË SHPËRBLIMEVE DHE ORËVE TË PUNËS TË INSTRUKTOREVE TË JASHTËM TË KONTRAKTUAR NGA BASHKIA PËRMET PËR VITIN 2026

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____ . ____ .2025, mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak” i ndryshuar, Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, VKM Nr.175 datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, VKM nr.511 datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore”, Udhëzimin Nr.21 datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore- edukative dhe numrit të nxënësve për klasë në institucionet e Arsimit parauniversitar” i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1.Numri i instruktorëve të jashtëm të kontraktuar nga Bashkia Përmet për vitin 2026 të jetë 6 instruktorë, të cilët do punojnë me fëmijët në sektoret:

a) Artistik dhe sportiv

b) Shkencor

2.Pagesa e shpërblimeve të Instruktorëve të jashtëm për vitin 2026 do të bëhet deri në 24 orë punë në muaj.

3.Llogaritja e pagesës për instruktorët do të jetë e njëvlefshme me pagën mësimore për një orë punë mësimore , në bazë të ligjeve dhe vendimeve në fuqi.

4.Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen nga 01.01.2026-31.12.2026

5.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISË

Alma HOXHA

Sheshi “Abdyl Frashëri”, tel.+35581322254; bashkiapermet.gov.al; e-mail: info@bashkiapermet.gov.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA PËRMET

RELACION
PËR

MIRATIMIN E NUMRIT, NIVELIT TË SHPËRBLIMEVE DHE ORËVE TË PUNËS TË
INSTRUKTOREVE TË JASHTËM TË KONTRAKTUAR NGA BASHKIA PËRMET PËR
VITIN 2026

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Përmet mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 “Detyrat dhe kopetencat e Këshillit Bashkiak” i ndryshuar, Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, VKM Nr.175 datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, VKM nr.511 datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore”, Udhëzimin Nr.21 datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrit të nxënësve për klasë në institucionet e Arsimit parauniversitar” i ndryshuar, gjatë vitit 2024 Bashkia Përmet ka kontraktuar 6 instruktorë të jashtëm të cilët kanë punuar me fëmijët në sektorë të ndryshëm.

Gjatë vitit 2026 Bashkia ka menduar që numri i instruktoresve të jashtëm të kontraktuar të jetë po i njëjti pra 6(gjashtë) instukturë të cilët do punojnë me fëmijët në sektorin artistik,sportiv,shkencor etj.

Kërkojmë nga ana juaj miratimin e numrit të instruktoresve që do kontraktohen nga Bashkia për të punuar me fëmijët në sektorë të ndryshëm.

Drejtori Shërbimit Social

Arjana PAPAPANO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. ____ Prot.

Përmet, më ____ . ____ . 2025

P/VENDIM

Nr. ____ datë 2025

"Për pranim në shtëpinë e të moshuarve Gjirokastrë"

Mbështetur në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; pikës 6 të Nenit Nr.29 të Ligjit Nr.9355, datë 10.03.2005 "Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" me gjithë ndryshimet V.K.M-se Nr. 209 datë 12.04.2006 dhe Udhëzimit Nr 2470, datë 06.12.2006, V.K.M-se Nr.425 , datë 27.06.2012 "Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale " VKM Nr. 839 datë 03.12.2014 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin 425 datë 27.06.2012 "Për kriteret e vendosjes në institucione rezidenciale të përkujdesit shoqëror dhe dokumentacionin e nevojshëm për pranim"

VENDOSI:

1.Të miratojë kërkesën e paraqitur nga qytetari:

Vangjel Topoviti, vendlindja Përmet.

për t'iu dhënë e drejta e kalimit në Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastrë për strehim , si banor i Qarkut Gjirokastrë,vëllait të tij z. Andrea Thanasi Topoviti.

2.Kërkohet për z.Andrea Topoviti përkujdesje nga ky institucion për shkak të sëmundjes së tij.

3. Dokumentacioni të kalojë në Shtëpinë e të moshuarve Gjirokastrë.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA PËRMET

RELACION
KESHILLIT BASHKIAK
PËR MET

Prand Drejtorinë e Shërbimeve Sociale në datë 05.11.2023 është paraqitur shtetasi Vangjel Topoviti, banor në Përmet me Nr ID F70724031 V i cili me kërkesën Nr 3689 Prot kërkon të ridisponohet nga bashkia për të sistemuar vëllain e tij Andresa Thanas Topoviti në shtëpinë e të moshuarve Gjyrokastër.

Andresa Topoviti me Nr ID F90212025T është banor i qytetit Përmet por për arsye ekonomike është larguar nga familja të cilës kaqë emigruar në Greqi dhe sot mbahet vetëm. Ai e ka sistemuar vëllain në një qendër private në qytetin e Tiranës për kostot për të janë shumë të larta (600 Euro në muaj) dhe në këto kushte ka më shumë të përballëjt dot me shpenzimet, kërkon që të arrijë vëllain e tij Andresa Topoviti pranë një institucioni shtetëror, a pikërisht të shtypur e të moshuarve Gjyrokastër pasi nuk ka më mundësi financiare për ta kështu për të në institucione private Vëllai i tij është i shpallur dhe ka nevojë për kujdes të vazhdueshëm.

Bashkia është institucioni përkatës që kujdeset për mirëqimin e banorëve në territorin e saj e në këto kushte duhet të mundësi më shumë për mirëqimin dhe sistemimin e kërkuarit pranë institucioneve shtetërore të shtypur e të moshuarve në Gjyrokastër për vëllain e tij e Andresa Topoviti.

Mbledhëtar në ligjin 159/2017 "Për mirëqimin e banorëve", pikë 6 të Nenet Nr 29 të Ligjit Nr 8335, datë 10.03.2007 "Për bashkimin dhe shpërbërjen shqiptare" me gjithë ndryshimet VKM-at Nr 208 datë 12.06.2010 dhe Udhëzimet Nr 5470, datë 06.12.2006, VKM-at Nr 425, datë 27.06.2012 "Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucione arsimore" VKM Nr 439 dt 03.12.2014 Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimet 425 datë 27.06.2012 "Për kriteret e vendosjes në institucione arsimore të përfaqësuar shqiptare dhe dokumentacionin e nevojshëm për pranimin" (Ligji Nr 124/2019, Për bashkimin e kushtetut shqiptar në Republikën e Shqipërisë. Adhokant që kjo kërkesë të mundësi paraqet dhe shtetasi Andresa Thanas Topoviti të arrijë pranë shtypur e të moshuarve Gjyrokastër.

Drejtori Shërbimeve Social

Ariana PAPAPANO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ Prot.

Datë _____.2025

P/VENDIM

Për dhënie titulli " Qytetar Nderi "

Në mbështetje të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" Neni 54 pika m,Neni 55 e në vijim, Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,Vendimi Nr.558 datë 20.11.2025 i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit, Ligji Nr.94/2022 " Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë,nenet 8 e në vijim, si dhe të VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë" Këshilli Bashkiak,me propozim të Kryetares së Bashkisë.

VENDOSI

1 – T'i japë titullin "Nderi Qytetit Përmet"

Z.Illir Ohri

me motivacionin :

" Për kontribut të shquar në kujdesin shëndetësor në fushën e mjekësisë,për vlerat e larta për mbrojtjen e shëndetit në komunitet dhe shpirtin e paepur të sacrificës,për aftësi të jashtëzakonshme për punën në skuadër, përkushtimin.profesionalizmin dhe humanizmin që e karakterizon.

2- Ky vendim shpallet brenda 10 ditëve nga data e miratimit.

KRYETARI
Alma HOXHA

Sheshi "Abdyl Frashëri";tel.+35581322254; bashkiapermet.gov.al;e-mail:info@bashkiapermet.gov.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Përmet më 26.11.2025

RELACION

Drejtuar : Këshillit Bashkiak
Lënda : Propozim për dhënie titulli "Qytetar Nderi "

Me propozim të familjarëve dhe kryetares së bashkisë Përmet znj.Alma Hoxha është paraqitur para Jush dokumentacioni dhe relacioni përkatës për dhënie titulli "Qytetar Nderi" për Z.Illir Ohri.

Po japim më poshtë një përshkrim të shkurtër për jetën dhe veprën e Prof.Illir Ohrit.

Prof.Illir Ohri,lindi në 27 Nëntor në vitin 1955 në Tiranë nga një familje përmetare me ndjenja të theksuara patriotike. Përfundoi me rezultate të shkëlqyera Fakultetin e Mjekësisë në vitin 1980 duke u bërë përfaqësues i brezit të tretë të mjekëve në familje,pas babait të tij Dr. Drini Ohrit dhe gjyshit Dr.Musa Ohrit.

Dr.Musa Ohri përveçse ishte një mjek i përkushtuar ishte dhe një nga firmëtarët e Kongresit të Përmetit,ndërsa dr.Drini Ohri ishte themeluesi i Shërbimit të Alergologjisë shqiptare si dhe ka mbajtur poste me rëndësi si Zv.Ministër i Shëndetësisë dhe drejtor i Spitalit Qendror Tiranë.

Bashëngjitur gjithë dokumentacioni përkatës për prof.Illir Ohri.

Me shkresën Nr.3336 Prot .datë 10.10.2025 ,bashkia ka kërkuar pranë Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit,bazuar në nenin7 pika 1 të Ligjit Nr.45/2015 " Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit në Republikën Socialiste të Shqipërisë" verifikimin e pastërtisë së figurës së Z.Illir Ohri.

Në rrugë elektronike pranë bashkisë Përmet datë 24.10.2025 Autoriteti Për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit ka kërkuar më shumë informacion për vendet e punës ku ka ushtruar detyrat doctor Ilir Ohri.

Me shkresën Nr.3556 datë 27.10.2025 bashkia Përmet ka dërguar pranë Autoritetit Për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit ,gjithë dokumentacionin e dërguar nga familja për prof.Illir Ohri.

Me vendimin Nr.558 datë 20.11.2025 Autoriteti Për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit ka vendosur për pastërtinë e figurës së Z.Illir Ohri.

Për këto arsye mendojmë se dhënia e titullit " Qytetar Nderi " për Z.Illir Ohri është nder i veçantë për qytetin që ka nxjerrë nga gjiri i saj një intelektual me nivel të lartë përfaqësimi.

Drejtori Shërbimit Social
Arjana PAPAPANO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Përmet më ____ . ____ .2025

P/VENDIM

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI
NËNTOR 2025**

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligji nr.9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, VKM Nr 868 datë 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike", VKM Nr617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597, datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave," Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore, të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.107 datë 18.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të bashkise për vitin 2025 dhe përcaktimin e numrit të punojseve të bashkise, institucioneve në varesi të saj" Këshilli Bashkiak me propozim të Kryetarit të Bashkise:

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike për Muajin NËNTOR 2025, 33 familje me një fond **123.500 lekë**.

2. Fondet të përballohen nga struktura :

1.Gr.00.Tit.AC135.Kap.05.Art.606.Kod produkti V043AAD per shumen 123.500 lekë

3. Familjet që përfitojnë janë si më poshtë:

Nr	Emri, Atesia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma/leke
1	Ziso Apostol Kristo	Valentina Polikron Kristo	3	4200
2	Xhilda Xhemal Selimllari	Xhilda Xhemal Selimllari	2	3600
3	Mitro Gani Zeqiri	Lefteri Rrapi Zeqiri	4	4700
4	Syrja Mehmet Hoxha	Beqar	1	3200
5	Drita Irakli Kosta	Divorcuar	2	3600
6	Lefteri Polikron Proko	E ve	1	3200
7	Andon Dhimitraq Kukureci	I ve	2	3600
8	Aferdita Nuredin Lahe	Beqare	1	3200
9	Arben Thoma Teka	Mirela Xheli Teka	6	5400
10	Viktor Josif Proko	Divorcuar	1	3200
11	Dhimo Naun Dimçi	Lindita Hysen Dimçi	3	4200
12	Vera Thanasi Nage	E ve	2	3600
13	Leonart Petro Markaj	Kristina Petraq Markaj	3	4200

14	Thoma Aristidh Ilia	Maria Nuredin Ilia	4	4700
15	Xhensila Maksim Jahhaj	Beqare me Femijë	2	3600
16	Violeta Guce Pelushi	Beqare	1	3200
17	Engjellushe Manxho Canollari	E ve	1	3200
18	Rivelino Fatmir Doko	Hurma Leonidha Doko	4	4700
19	Bajame Fari Hysenshahaj	E ve	1	3200
20	Lida Koco Thomollari	Divorcuar	1	3200
21	Vasilika Bedri Malka	E ve	2	3600
22	Ilir Sali Jashari	Beqar	1	3200
23	Vitori Llazo Caci	Beqare	2	3600
24	Luam Ferit Zeneli	Gezime Tafil Zeneli	4	4700
25	Ilber Kudret Dalipaj	Divorcuar	1	3200
26	Kastriot Kristo Koto	Kastriot Kristo Koto	3	4200
27	Kastriot Astrit Male	Divorcuar	1	3200
28	Vangjush Thanasi Mamillo	Gentiana Seit Mamillo	3	4200
29	Bari Avni Zaimi	Valbona Zenel Zaimi	2	3600
30	Kadri Petrit Maska	Beqar	1	3200
31	Dashnor Guce Pelushaj	Vezire Ali Pelushaj	4	4700
32	Klodiana Kristofor Peçi	Divorcuar	1	3200
33	Lulëzim Barjam Beqari	Divorcuar	1	3200
	SHUMA			123.500

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Finances dhe Tatim –Taksa/Spektori i Buxhet Financës.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë mbas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXH





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET



Nr. _____ prot.

Përmet më _____.2025

RELACION

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI
NËNTOR 2025**

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligji nr.9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, VKM Nr 868 datë 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike", VKM Nr.617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597, datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore, të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.107 datë 18.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2025 dhe përcaktimin e numrit të punojësve të bashkisë, institucioneve në varësi të saj. Familje të cilat janë përfituese në fondin e bashkisë janë ato familje të cilat mbasi kanë bërë aplikimin në Sistemin e Ndihmës ekonomike, rekomandimin në fondin 6% nuk janë fituese. Dhe nga vizitat e kryera në familje nga Administratorët shoqëror duke parë gjëndjen ekonomike të këtyre familjeve të cilat janë në gjëndje të dobët ekonomike u arsyetua që të përfshihen në fondin e familjeve në nevojë.

Përsa më sipër rekomandojmë të ndihmohen për muajin Nëntor 33 familje me një vlerë prej 123.500 lekë.

Specialisti i NE

Jurigen SIMONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Përmet më _____ 2025

P/VENDIM

Për miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmës ekonomike, deri në 6% .

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligji nr.9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmen dhe shërbimet shoqërore " i ndryshuar me VKM nr.868 dt.29.12.2021 "Per disa ndryshime ne Vendimin 597 dt.04.09.2019 të K.M."Për percaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmës ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese,mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike,VKM nr.85 dt.10.02.2021,nr.617,date 22.09.2022 i perditesuar: Vendimin e Keshillit Bashkiak Permet me fondet e Buxhetit Vendor.VKB nr.107 date 18.12.2024 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2025 dhe percaktimin e numrit te punojseve të bashkise, institucioneve në varesi të saj". Keshilli Bashkiak,me propozim të Kryetares së Bashkisë:

VENDOSI

1.Të perfitojnë ndihme ekonomike per Muajn Tetor 2025, 6 familje me një fond prej 21.184 lekë.

2. Familjet që perfitojne jane si më poshtë:

Nr	Emri, Atesia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma
1	Ylli Guçe Pelushaj	Zylkade Qerim Pelushaj	2	3.703
2	Roland Petraq Jorgji	Divorcuar	1	2.178
3	Lame Enver Ferati	Silvana Kujtim Ferati	3	5.227
4	Mimoza Skënder Gjoka	Divorcuar	1	2.178
5	Lefteri Mihal Tyto	Divorcuar	1	5.720
6	Flavia Musa Pelushaj	Begare	1	2.178
	SHUMA			21.184

3..Ngarkohen per zbatimin e ketij vendimi sektori buxhet-finance dhe zyra e ndihmes ekonomike.

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET



Nr. _____ prot.

Përmet më _____, 2025

RELACION

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËS
EKONOMIKE, DERI NË 6% .**

Mbështetur në Ligjin Nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji Nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" Ligji 935 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar me VKM Nr.955 datë 07.12.2016 (kreu II pika 13) dhe udhëzimi nr.5 datë 17.02.2017 pika 2 i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. Për përcaktimin kriterëve, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike si dhe VKM nr.85 datë 10.02.2021, nr.868, datë 29.12.2021; nr.617, datë 22.09.2022 i përditësuar Vendimi i Këshillit Bashkiak Përmet me fonde të Buxhetit Vendor Nr.107 datë 18.02.2024 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2025 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, institucioneve në varësi të saj "Këshilli Bashkiak ka të drejtë të trajtojë me ndihmë ekonomike familjet aplikuese që nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, deri 6% të bllok ndihmës ekonomike të muajit Tetor 2025 me Vendim të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Gjirokastrë. Nr.10/2022 datë 27/10/2022 për dhënien e NE për periudhën 01-31-2025 Për Bashkinë Përmet. (Sipas vendimit të Muajit Tetor 2025).

Për sa më sipër vlera e fondit të kushtëzuar (bllok ndihma ekonomike) për Muajin Tetor 2025

është 49 familje me, Shumën prej 378.650 lekë dhe për tu trajtuar familje me ndihmë ekonomike janë në dispozicion 6% e këtij fondi ose 22.719 lekë, për Muajin Tetor 2025.

Mbështetur në të dhënat për dhënien e Ndihmës Ekonomike për periudhën 1-31 Tetor 2025 kanë aplikuar 6 familje asedhenjë familje nuk ka dale fituese 49 janë përfituese në skemën e Ndihmës Ekonomike.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikuesve që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme për periudhën 01 Tetor deri më datën 31 nga vlerësimi i SH.S.SH rekomandojmë:

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar prej 6%, 6 familje me një vlerë 21.184 lekë, nga ku fondi 6% në total sipas vendimit është në Shumën 22.719 lekë do të mbetet e përdorur për muajin Tetor.

Specialisti i NE

Jurigen SIMONI

INFORMACION

KËSHILLIT TË BASHKISË PËRMET

MBI REALIZIMIN E TË ARDHURAVE VENDORE , 10 - MUJORI 2025

Përgatiti : Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Tatim Taksave.

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Paketën Fiskale të vitit 2025, miratuar me VKB nr.96, datë 27.11.2024, Sektori i Tatim Taksave Aseteve dhe Licencave, si dhe duke bashkpunuar dhe me sektor të tjerë të cilët në punën e tyre janë pjesë vjeljes së të ardhurave vendore, gjatë periudhës Janar - Tetor 2025, është bërë një punë e mirë për të arritur objektivat e planifikuara në fillim të vitit .

Të ardhurat të cilat janë planifikuara për t'u mbledhur nga ky sektor në vitin aktual 2025, janë të ardhura Tatimore dhe Jo Tatimore, të cilat specifikohen si më poshtë.:

TE ARDHURA TATIMORE

Taksa mbi ndertesat

Taksë mbi truallin

Tatim I thjeshtuar mbi fitimin

Takse e ndik.infr.nd.reja dhe
legalizimet

Takse mbi kalimin e te drejtes se
prones.

Takse Rregjistrim automjeti

Takse Tabele

Taksë mbi tokën bujqësore

Taksë fjetje në hotel

Tatim mbi të ardhurat personale

Takse shitje pasuri e paluajtshme

TE ARDHURA JOTATIMORE

Tarife Pastrimi

Tarife Ndricimi

Tarife Gjelberimi

Leje Rregjistrim Veprimtarie

Qera Objekti

Te ardhura nga kopeshti dhe
cerdhja

Tarife Parkimi

Tarifë për lëndë drusore

Tarifë zënie hapësirë publike

Tarifë kullotje bagëtie

Tarifë mirëmbajtje kanale vaditës

Të ardhura nga ndermarret dhe
pronesia

Tarifa vendore nga urbanistika

Tarifa shërbimesh të MNZ

Takse vendore uji



Te tjera te ardhura
Certifikate perdorimi
Tarife vendore per shqyrtim ose
nxjerje dosje
Qera toke bujqesore

Si paraqitet situata e vjeljes së të ardhurave gjate kësaj periudhe? Më
poshtë në tabelë po paraqsim plan -fakt vjeljen e të ardhurave vendore
të Bashkisë Përmet Janar-Tetor .

ORGANI I PUSHTETIT VENDOR ; BASHKIA PERMET

TABELA E PLANIT TE TE ARDHURAVE Janar- Tetor 2025

NR	LLOJI I TE ARDHURAVE	PLANI		Fakt 10 muor	% me planin 10-- muor	diferenca
		VJETOR	Tetor			
A	TE ARDHURA TATIMORE	34625	31626	28744	91	
1	Taksa mbi ndertesat	12000	11276	9705	86	-1571
2	Taksë mbi truallin	1700	1559	1330	85	-229
3	Tatim I thjeshtuar mbi fitimin	0	0	39		39
4	Takse e ndik.infr.nd.reja dhe legalizimet	7000	6250	5076	81	-1174
5	Takse mbi kalimin e te drejtes se prones.	500	500	112	22	-388
6	Takse Rregjistrim automjeti	6000	5614	5152	92	-462
7	Takse Tabele	400	400	419	105	19
8	Taksë mbi tokën bujqësore	2025	1875	2174	116	299
9	Taksë fjetje në hotel	500	500	202	40	-298
10	Tatim mbi të ardhurat personale	4500	3652	4528	124	876
11	Takse shitje pasuri e paluajtëshme	0	0	7	0	7
B	TE ARDHURA JOTATIMORE	40240	37284	36914	99	-370
1	Tarife Pastrimi	13000	11931	14374	120	2443
2	Tarife Ndricimi	7000	6896	3826	55	-3070
3	Tarife Gjelberimi	2000	2000	2194	110	194
4	Leje Rregjistrim Veprimtarie	1800	1650	1636	99	-14



5	Qera TOKE BUJQESORE	0	0	102	0	102
6	Te ardhura nga kopeshti dhe cerdhja	1500	1375	826	60	-549
7	Tarife Parkimi	500	500	78	16	-422
8	Tarife për lëndë drusore	1100	830	1210	146	380
9	Tarife zënie hapësirë publike	1200	1130	1513	134	383
10	Tarife kullotje bagëti	2500	2375	1223	51	-1152
11	Tarife mirëmbajtje kanale vaditës	600	600	259	43	-341
12	Te ardhura nga ndermarrjet dhe pronesia	6540	5537	4405	80	-1132
13	Tarifa vendore nga urbanistika	1500	1500	3259	217	1759
14	Tarifa shërbimesh të MNZ	500	460	57	12	-403
15	Certifikate perdorimi	0	0	186	0	186
16	Te tjera te ardhura	500	500	136	27	-364
18	Tarife vendore per uje			156		156
20	sekuestrime e gjoba			636		636
21	sponsorizime			838		838
	Të ardhura viti 2025	74865	68910	65658	95.3	-3252
	VITI 2024			49131	133	16527



Realizimi i të ardhurave për periudhën raportuese Janar Tetor viti 2025, sic shihet dhe nga tabela e mësipërme është në vlerën 65,658,000 lekë ose 3,252,000 lekë më pak se plani i periudhës raportuese, kjo vlerë u takon bizneseve dëbitorë për periudhën raportuese.
I shprehur në përqindje ky realizim krahasuar me planin 10- muor është 95.3 %

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar janë grumbulluar 16,527,000 lekë më shumë.

Rritja më e madhe ishte te taksa e pasurisë, Tarifat vendore nga ndërmarrjet dhe pronësia, taksa e ndikimit në infrastrukturë, tarifa vendore e urbanistike, tarifa e pastrimit etj.

Nga Sektori i Tatim Taksave, Aseteve dhe Licencave është punuar maksimalisht për realizimin e të ardhurave të periudhës raportuese dhe njëkohësisht për të grumbulluar të ardhura nga detyrimet e prapambetura për të ulur borxhin tatimor.

Për vitin 2025 janë aktiv 517 biznese dhe 22 institucione.

Kanë mbyllur aktivitetin 11 biznese, kryesisht biznes i madh 2, biznes i vogël me tvsh 2 dhe 7 biznese të vegjël.

Janë hapur gjithsej 18 biznese, kryesisht 1 biznes i vogël me tvsh, 2 biznes të madha karburant dhe tregëti dhe shërbime.

Janë ndjekur të gjitha fazat e njoftimeve dhe rinjoftimeve konform ligjit 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurata Tatimore në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimi nr.24, datë 02.09.2008 "Për procedurata Tatimore", kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor"

E rëndësishme të thuhet në këtë raportim është rritja e vjeljes së taksës së pasurisë në periudhën raportuese krahasuar me vitin 2024, gjë që ndikonte në vlerësimin e performancës së Bashkisë Përmet.

Në vitin 2024 Taksa e Pasurisë ishte realizuar në periudhën 10 mujore 8,575,000 lekë, kurse në të njëjtën periudhë të këtij viti është realizuar 13,209,000 lekë.

Përmendim se gjatë kësaj periudhe nuk janë pasqyruar në raportim të ardhurat e mbledhura nga SHA Ujësjellës muaji shtator. Detyrimisht niveli i të ardhurave në periudhën raportuese do të ishte akoma më i lartë.

Gjatë kësaj periudhe është bashkëpunuar me Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve Gjirokastër si Agjent Tatimor, për derdhjen në kohë të të ardhurave të grumbulluara nga popullata. Detyrimi vjetor i të ardhurave për popullatën është shpërndarë në 10 muaj.

Arkëtimet nga ujësjellësi gjatë kësaj periudhe kanë qënë në vlerën 14,446,570 lekë, kundrejt planit të periudhës vjetore 15,032,201 lekë.

E gjithë vëmendja e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik ,Bujqësisë dhe Turizmit në këtë periudhë është përqëndruar në mbledhjen e detyrimeve të prapambetura të subjekteve debitorë ndër vite,me qëllim uljen e borxhit tatimor dhe nritjen e performancës së Bashkisë.

Për periudhën që raportojmë kanë shlyer detyrimet e prapambetura,rreth 46 subjekte, në vlerën 1,970,908 lekë,këto pagesa janë për periudhën 2013-2024.

Njëkohësisht në bazë të vendimit të KB nr.datë është bërë faturimi i bizneseve debitor për vitin 2025 nga SHA Ujësjetllës në muajin Nëntor.

Besojmë se me këtë hap niveli i të ardhurave do t'i përafrohet planit vjetor edhe më shumë.

Sfidë për ne ngelet ulja e borxhit tatimor,sistemimi i taksës së pasurisë,kjo si për ndërtesat ,tokën bujqësore ,truallin,por edhe vënia në eficencë e aseteve të Bashkisë Përmet .

Ju faleminderit!

Përgjegjësi i Sektorit të Tatim Taksave

Dorjan METKO



Drejtori i Zhvillimit Ekonomik

Etleva MYFTARI

